



AGJENCIA E MBIKËQYRJES TË SIGURIMEVE

RAPORTI VJETOR

MBI PUNEN E AGJENCISE SE MBIKËQYRJES
SE SIGURIMEVE PER VITIN 2020

RAPORTI VJETOR

MBI GJENDJEN DHE LEVIZJEN NE
TREGUN E SIGURIMEVE NE VITIN 2020

Raporti është përgatitur në përputhje me nenin 158-o të Ligjit për Mbikëqyrje të Sigurimeve dhe për përgatitjen e tij Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve ka përdorur të dhëna nga evidenca personale.

PËRMBAJTJA

I. FJALIMI HYRËS	4
------------------------	---

II. MBI PUNËN E AGJENCISË SË MBIKËQYRJES SË SIGURIMEVE PËR VITIN 2020

1. HYRJA	10
2. MENAXHIMI INSTITUCIONAL.....	11
2.1. PUNA E KËSHILLIT TË EKSPERTËVE.....	11
2.2. MISIONI DHE VIZIONI.....	11
2.3. VLERAT.....	11
2.4. STRATEGJIA PËR MENAXHIM ME RREZIQET.....	11
2.5. PLANIFIKIMI I PUNËS SË AMS-SË	11
2.6. AUDITIMI I BRENDSHËM.....	12
2.7. ORGANIZIMI DHE FINANCIMI I AMS-SË	12
2.8. PËRGJEGJËSIA KORPORATIVE SHOQËRORE	12
3. AKTIVITETE TË REALIZUARA NË PERIUdhËN E RAPORTIT SIPAS FUSHAVE.....	13
3.1. LEGJISLACIONI DHE LICENCIMI	13
3.2. RREGULLORE TË MIRATUARA.....	13
3.3. LEJE DHE MIRATIME TË DHËNA.....	13
3.4. LICENCA TË DHËNA.....	14
3.5. LEJE DHE LICENCA TË REVOKUARA.....	14
3.6. TRAJNIME TË ORGANIZUARA.....	14
4. ZBATIMI I MBIKËQYRJES.....	14
4.1. MBIKËQYRJA NË TERREN.....	15
4.2. MBIKËQYRJA OFF-SITE	15
4.3. PIKËPAMJE DHE QARKORE.....	15
5 BASHKËPUNIMI.....	15
6. ORGANIZIMI I EVENIMENTEVE.....	15
7. EDUKIMI DHE NDËRTIMI I KAPACITETEVE.....	16
8. MBROJTA E KONSUMATORËVE, EDUKIMI FINANCIAR DHE INKLUZIONI FINANCIAR.....	16
9. AKTIVITETE PROJEKTUESE.....	17
10. INFORMIMI I PUBLIKUT DHE TRANSPARENCA.....	17

III. MBI GJENDJEN DHE LËVIZJEN NË TREGUN E SIGURIMEVE NË VITIN 2020

1. HYRJA	20
2. KORNIZA LIGJORE.....	21
3. TREGU I SIGURIMEVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT.....	23
3.1. SHOQËRITË E SIGURIMEVE.....	23
3.1.1. STRUKTURA E PRONËSISË.....	23
3.1.2. NORMA E ZHVILLIMIT.....	24
3.1.3. PRIMI I SHKRUAR BRUTO	26
3.1.4. STRUKTURA E PJESËMARRJES.....	29
3.1.5. DËME BRUTO TË PAGUARA.....	31
3.1.6. MJETE DHE BURIME TË MJETEVE.....	32
3.1.7. PROVIGJONE TEKNIKE.....	35
3.1.8. MJETE TË CILAT I MBULOJNË REZERVAT TEKNIKE.....	35
3.1.9. ADEKUATSHMËRIA E KAPITALIT TË SHOQËRIVE TË SIGURIMIT.....	37
3.1.10. REZULTATI FINANCIAR NGA PUNA.....	38
3.1.11. INDIKATORË PËR SEKTORIN E SIGURIMEVE.....	39
3.2. NDËRMJETËSIMI NË SIGURIMET.....	41
3.2.1. PËRFAQËSIMI NË SIGURIMET.....	41
3.2.1. AKTIVITETE TË BROKERIMIT NË SIGURIME.....	42
3.3. BYROJA NACIONALE E SIGURIMEVE.....	45

Fjalimi hyrës

Të nderuar,

Në vitin e kaluar 2020 bota u ballafaqua me një pandemi me përmasa të papara e cila i zhvendosi kufijtë e punës dhe jetës normale, kurse fundi dhe rezultati përfundimtar i së cilës janë ende të pasigurta.

Bota po ballafaqohet me humbje të mëdha të jetëve njerëzore, të shprehura në miliona, si rezultat i këtij virusi. Zbulimi i vaksinës dhe aksesit i saj ishte në fokusin e çdo shteti. Me qëllim që të pengohet përhapja e virusit dhe të zvogëlohet presioni mbi sistemin shëndetësor, qeveritë kombëtare në mbarë botën ndaluan lëvizjen e lirë të qytetarëve, ndërsa për këtë arsye janë mbyllur shumë biznese, kurse mijëra punëtorë i humbën vendet e punës. Kjo u reflektua edhe mbi ekonominë globale e cila shënon një ulje vjetore prej 3,2% ndërsa shtetet që janë pjesë e Bashkimit Evropian shënuan ulje prej 6,5%. Institucionet arsimore, subjektet afariste dhe institucionet shëndetësore inkorporuan një mënyrë të re pune nga distanca, që kontribuoi për rritjen e shpejtë të përdorimit të pajisjeve elektronike dhe të softuerit. Digjitalizimi i proceseve dhe përdorimi i teknologjisë informatike në punën e përditshme, deri para pak kohe ishte përmendur vetëm në letër, në kontekstin e dokumenteve për planifikime afatgjata strategjike të organizatave, kurse tani jemi dëshmitarë kur digjitalizimi është pjesë e jetës sonë të përditshme që konsiderohet si mundësi dhe fitim për shoqëritë në këto kushte të jashtëzakonshme.

Në fillim të krizës, bursat globale të cilat kanë tregtuar aksione dhe fletë obligacioni të lëshuara nga korporatat ndërkombëtare të mëdha shënuan një ulje të madhe në vlerat e tregut, që mandej, deri në fund të vitit, të stabilizohen dhe të kthehen në të njëjtin nivel madje edhe në nivel më të lartë në krahasim me vlerën që e kishin para shpalljes së pandemisë. Pritjet e institucioneve ndërkombëtare financiare janë se ekonomia globale do të rimëkëmbet dhe se në vitin 2021 ekonomia botërore do të shënojë rritje të theksuar prej rreth 6% para së gjithash si rezultat i pritjeve të rritjes së ekonomive më të mëdha botërore,



SHBA-së dhe Kinës.

Sektori global financiar tani për tani është rezistent ndaj krizës, që kryesisht i dedikohet faktit që pas krizës së madhe financiare u rritën në mënyrë të theksuar kërkesat kapitale për bankat dhe institucionet e tjera financiare jobankare dhe kërkesa për menaxhim të mirë korporativ me rreziqet, krijuan në kohë rezerva të mjaftueshme, të cilat në këto kushte të jashtëzakonshme, u mundësuan punë pa ndërprerje dhe plotësim të kërkesave të përdoruesve të shërbimeve financiare.

Në plan ndërkombëtar, shoqëritë e sigurimeve po luajnë përsëri një rol të rëndësishëm dhe të pazëvendësueshëm si institucione financiare të cilat sigurojnë mbrojtje, siguri, stabilizim dhe normalizim në mjedise të ndryshme të prekura nga llojet e ndryshme të krizave dhe rreziqeve. Ngjashëm si në periudhën e krizës së madhe financiare, kur burimi i krizës ishin vetëm institucionet kreditore financiare, ashtu edhe në këto kushte të jashtëzakonshme të shkaktuara nga kriza shëndetësore, por edhe nga ballafaqime me pasojat të cilat vijnë si rezultat të ndryshimeve globale klimatike dhe të fatkeqësive të shpeshta natyrore të përmasave të mëdha, është i madh roli dhe

rëndësia që japin shoqëritë e sigurimeve për parandalimin e përhapjes, zvogëlimin dhe zbutjen e humbjeve dhe të dëmeve.

Kriza shëndetësore globale shkaktoi humbje të mëdha edhe tek ne, si në aspektin e numrit të jetëve të humbura njerëzore ashtu edhe në aspektin e pasojave ekonomike si rezultat i ndërprerjes së punës dhe mbylljes së bizneseve. Ekonomia maqedonase vitin 2020 e përfundoi me një rënie prej 4,5%.

Mendimi im është se tregu i sigurimeve po ballafaqohet me sukses me sfidat. Si rezultat i masave të ndërmarra në kohë, i kapaciteteve për ballafaqim me krizat dhe njohjes së prioriteteve, në pikëpamje të plotësimit të nevojave të të siguruarve dhe përdoruesve të sigurimeve, sektori i sigurimeve po e ruan gjendjen e mirë financiare duke i zgjeruar shërbimet në drejtim të plotësimit të kërkesave të të siguruarve dhe të përdoruesve të sigurimeve.

Në vitin 2020, shoqëritë e sigurimeve shënuan një ulje të primeve të shkruara, ulje e cila e shprehur në indikatorë relevantë është e krahasueshme me uljen e ekonomisë maqedonase në tërësi. Primi i shkruar bruto në sigurimet jo-jetë është 8,32 miliarda denarë, që është 4,88% më pak në krahasim me vitin 2019, kurse sigurimet e jetës kanë qenë 1,74 miliardë denarë, ose 4,93% më pak në krahasim me vitin e mëparshëm.

Duke pasur parasysh faktin se viti 2019 është viti kur u arrit maja në aspektin e vëllimit të punës së shoqërive të sigurimeve matur sipas primeve të shkruara bruto, ulja vjetore e primeve në vitin 2020 nuk është edhe kaq serioze, madje, krahasuar me vitin 2018, tregu qëndron më mirë, edhe përkrah kushteve të jashtëzakonshme të punës së shoqërive në vitin 2020. Rënie më e madhe është regjistruar te blerja e kartonave jeshilë si sigurim shtesë e automjeteve për udhëtim jashtë shtetit dhe te sigurimet e udhëtarëve, që edhe pritej duke pasur parasysh ndalimet për udhëtime jashtë shtetit. Por, rënie është shënuar në sigurimin e jetës, para së gjithash te sigurimet e pastra të rrezikut të cilat sigurojnë mbulim të rrezikut të vdekjes dhe të

cilat më shpesh janë bërë gjatë marrjes së kredive nga bankat si sigurim i bankës nga rreziku kreditor i kredimarrësit, si dhe te sigurimet tradicionale, të a.q. sigurime të përziera të jetës, të cilat sigurojnë rrezik nga vdekja dhe mbijetimi.

Janë për t'u vënë në dukje dhe inkurajuar tendencat pozitive shumëvjeçare të rritjes së vazhdueshme të sigurimeve vullnetare, para së gjithash sigurimi shëndetësor dhe sigurimi i pronës së personave juridikë dhe fizikë nga rreziqet e ndryshme, nga rreziqet themelore nga zjarri në ndërtesat në ndërtim, shtëpitë për të jetuar, biznese, pronat shtetërore, deri në rreziqe shtesë nga vjedhjet, përmytjet, si dhe sigurime të pronës bujqësore nga fatkeqësitë natyrore. Mandej është shënuar rritje te sigurimi i kredive, garancive dhe humbjeve financiare për shkak të ndalimit të punës, kurse po rritet edhe sigurimi i jetës lidhur me pjesëmarrjet në fondet investuese ku i siguruari e ndërmerr rrezikun nga investimi, ose të a.q. unit-linked sigurime të jetës.

Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve i dalloj në kohë rreziqet e reja ndaj të cilave është ekspozuar industria e sigurimeve, të cilat e kanë prejardhjen nga jashtë, përkatësisht dalin nga kriza shëndetësore dhe në suazat e kompetencave të veta ndërmerr masa për zbutjen e efekteve negative në tregun e sigurimeve.

Shërbimet profesionale të Agjencisë dhe udhëheqjes së Agjencisë kanë punuar pa ndërprerje, me kapacitet të plotë, kurse kanë zbatuar masa të shumta me qëllim që të mundësohet fleksibilitet më i madh i shoqërive të sigurimeve në dakordimin e mbulimeve të reja të sigurimeve si dhe në rinovimin e marrëveshjeve të sigurimeve të cilat kanë përfunduar në këtë periudhë.

Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve mundësoi fleksibilitet më të madh për subjektet në tregun e sigurimeve në pikëpamje të shtyrjes së afateve të përpilimit dhe dorëzimit të raporteve; i shtyu mbikëqyrjet e planifikuara në terren, si dhe zbatoi mbikëqyrje tematike off-site me të njëjtin

intensitet dhe cilësi të kontrollit; i shtyu trajnimet dhe provimet e planifikuara për përfaqësues në sigurime dhe brokerë sigurimi; i ndërpreu procedurat e filluara për sanksionim të shkeljeve të konstatuara më parë të dispozitave të ligjeve në kompetencë të saj; i ndryshoi përkohësisht rregullat e vlerësimit të të arkëtueshmeve në bazë të primeve duke u mundësuar kështu shoqërive të sigurimeve fleksibilitet më të madh në punë dhe të mos reflektohet më seriozisht në rezultatin financiar. Masat e tilla, si dhe fakti se shoqëritë e sigurimeve për shkak të vëllimit të zvogëluar të punës janë më pak të ekspozuara ndaj rreziqeve të ndërmarra në sigurime, shkaktuan përmirësim të theksuar të përfitimit në tregun e sigurimeve në fund të vitit 2020. Me qëllim që të ruhet ky ritëm i mirë financiar dhe gatishmëria që t'i përgjigjet me sukses kohëzgjatjes së krizës, para pak kohe Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve i riafirmoi rekomandimet të cilat ua dha së pari shoqërive të sigurimeve në prill të vitit 2020 që të distancohen nga pagesa e dividendëve, bonuseve dhe shpërblimeve të tjera të mjeteve të akumuluar në fitime dhe rezerva të shoqërive të sigurimeve, dhe këto mjete t'i mbajnë në kompani.

Në fushën e miratimit të normativës ligjore, i përmbushëm tërësisht planet tona për vitin 2020 dhe për gjysmën e parë të vitit 2021. Domethënë, në një procedurë transparente dhe në afat kohor të arsyeshëm Agjencia miratoi disa akte themelore nënligjore me të cilat i përmirësoi terminologjikisht rregullat e vendosura minimale mbi llogaritjen e provigjoneve teknike; i përmirësoi rregullat e vendosura për pranim, trahtim dhe pagim të kërkesave për kompensim të dëmeve dhe të shumave të siguruara; i përmirësoi standardet minimale për sistemet informatike të subjekteve në tregun e sigurimeve; vendosi standarde minimale për raportimin e të dhënave sipas marrëveshjeve të sigurimeve të jetës lidhur me pjesëmarrjen në fondet investuese ku i siguruari e ndërmerr rrezikun e investimeve; si dhe miratoi udhëzime për zbatim të kërkesave minimale për vendosjen e sistemeve për parandalim të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në sigurime. Harmonizimi i përhershëm me dispozitat e

këtyre rregulloreve nga shoqëritë e sigurimeve dhe pjesëmarrësit e tjerë në tregun e sigurimeve do të nënkuptojë garanci për funksionim të rregullt të tregut të sigurimeve dhe zmadhim të besimit të opinionit në shërbimet e sigurimeve, që do të kontribuojë për rritjen e mëtejshme dhe inkluzionin e sigurimeve.

Në vitin 2021, pas një pushimi prej më shumë se një dekade, filluam një cikël të ri trajnimesh dhe provimesh profesionale për aktuarë. Zhvillimi i aktuarizmit dhe i numrit të personave profesionalë të cilët punojnë si aktuarë në shoqëritë e sigurimeve do të kontribuojë në përmirësimin e besueshmërisë dhe relevancës së vlerësimeve të rreziqeve të ndërmarra në sigurim dhe si rrjedhim për zmadhimin e besueshmërisë gjatë matjes së aftësisë paguese dhe stabilitetit të shoqërive të sigurimeve.

Agjencia i menaxhon me sukses aktivitetet e projektit që lidhen me zëvendësimin e softuerit ekzistues për mbikëqyrje me një të ri i cili do të mundësojë siguri më të madhe dhe do të përmirësojë theksueshëm efikasitetin dhe efektivitetin në procedurat e mbikëqyrjes dhe tranzitim dhe pranim më të lehtë të rregullativës së re për sigurimet të a.q. Solvencë 2.

Në realizimin e qëllimeve dhe programeve strategjike të Agjencisë, në punën tonë të përditshme u japim përparësi dhe rëndësi të njëjtë lëndëve që arrijnë në Agjenci në formën e ankesave dhe apelimeve nga të siguruarit dhe përdoruesit e sigurimeve kundër shoqërive të sigurimeve dhe subjekteve të tjera të tregut, si dhe rëndësisë që ne ua japim lëndëve që lidhen me zbatimin e mbikëqyrjes të bazuar në kontrollimin e gjendjes financiare dhe aftësisë paguese të shoqërive të sigurimeve. Përveç zbatimit të mbikëqyrjes prudente dhe vlerësimit të solvencës së shoqërive të sigurimeve, Agjencia, me të njëjtën vëmendje dhe resurse i qaset edhe kontrollit të sjelljes së tregut nëpërmjet kontrollit të kushteve për sigurim të shoqërive të sigurimeve, zbardhjen e informacioneve gjatë pranimit në sigurime, analizës së ankesave të zbatuara të dorëzuara kundër shoqërive të sigurimit në lidhje me zbatimin e kushteve për sigurime dhe obligime

të shoqërive të sigurimeve sipas marrëveshjeve për sigurime.

Jam veçanërisht krenar për faktin se e rritëm transparencën e Agjencisë dhe veprojmë në mënyrë parandaluese në treg në kuptimin që i shpallim të dhënat dhe informacionet të cilat konsiderojmë se janë relevante për të siguruarit, që ndikon pozitivisht në përmirësimin e kuptimit të prodhimeve të sigurimit dhe si rrjedhim në përmirësimin e ofertës për mbulimet e sigurimeve. Personalisht jam i bindur se ende ekziston një hendek i madh midis ofertës së shërbimeve të sigurimeve dhe nevojave për sigurime, kurse shkalla e zhvillimit të tregut të sigurimeve është shumë larg atij potenciali.

Vitin e kaluar, Agjencia u ballafaqua me sukses me një dukuri dhe praktikë të tregut që një periudhë të gjatë ekzistonte në tregun e sigurimeve, kurse ishte në kundërshtim me kërkesat ligjore për papajtueshmëri në ushtrimin e aktiviteteve të sigurimit jo-jetë dhe sigurimit të jetës. Iniciativat dhe kërkesat e shumta për harmonizim të dispozitave, të dorëzuara nga shoqëritë e sigurimeve të jetës në Agjencinë për Mbikëqyrje të Sigurimeve, në disa nga vitet e kaluara, se shoqëritë për sigurim jo-jetë në kundërshtim me kërkesat ligjore ofrojnë mbulime të sigurimeve për rreziqe të cilat sipas Ligjit për Mbikëqyrje të Sigurimeve mund ta japin vetëm shoqëritë e sigurimeve të jetës, kurse lidhet me ofertën e mbulimit të personave fizikë për rrezikun vdekje nga sëmundja si sigurim shtesë për sigurimin nga pasojat e rastit të fatkeqësisë, përkatësisht sigurim shëndetësor, Agjencia ndërmoi masa, me të cilat ndaloi që shoqëritë për sigurim jo-jetë në të ardhmen të ofrojnë mbulime të tilla pa pasur ndikim kjo mbi cilësinë dhe vazhdimësinë e mbulimit të sigurimit të cilin e kanë pasur deri më tani kontraktorët e sigurimeve, në kuptimin se tani mbulime të tilla ofrojnë vetëm shoqëritë e sigurimeve të jetës.

Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve ka marrë pjesë aktivisht në të gjitha takimet e punës në suazat e kolegjeve të mbikëqyrjeve të cilat janë organizuar nga organet e mbikëqyrjes të kompanive amë të sigurimeve në rrugë virtuale, dhe në suazat e marrëveshjeve ndërkombëtare për bashkëpunim, shkëmbim të informacioneve për shoqëritë vendase të sigurimeve të cilat janë pjesë e grupeve ndërkombëtare të sigurimeve.

Në këtë mënyrë Agjencia e përmirëson kuptimin e planeve afatgjata dhe të menaxhimit me kompanitë vendase të sigurimeve të cilat janë pjesë e grupit të sigurimeve që ka ndikuar gjithsesi në përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të mbikëqyrjes dhe të rregullativës së mbikëqyrjes.


Agjencia e Mbikëqyrjes së sigurimeve u jep gjithashtu rëndësi dhe prioritet të njëjtë aktiviteteve lidhur me përpilimin e ligjit të ri të sigurimeve që është në kompetencë të Ministrisë së Financave. Nëpërmjet pjesëmarrjes në grupin e punës të themeluar nga Ministria e Financave, Agjencia përpilon propozim-tekst të ligjit të ri i cili duhet t'i inkorporojë tërësisht parimet dhe standardet ndërkombëtare të sigurimit dhe rregullativën evropiane për sigurim dhe mbikëqyrje të sigurimeve.

Në fund të vitit 2020 në Agjencinë e Mbikëqyrjes të Sigurimeve punojnë 32 të punësuar gjithsej të shpërndarë në vende pune në tri shërbime profesionale dhe dy drejtori të pavarura. Këshilli i Ekspertëve i Agjencisë është kompetent për marrjen e vendimeve të Agjencisë dhe ai ka pesë anëtarë, prej të cilëve kryetari dhe dy anëtarë janë të angazhuar profesionalisht me orar të plotë pune në Agjenci. Në Agjenci është vendosur edhe sistem funksional për menaxhim me cilësinë në përputhje me kërkesat e standardit ndërkombëtar ISO 9001:2015 për të cilin Agjencia ka marrë certifikatë për rakordim me këtë standard në maj të vitit 2021.

Më shumë informacione mbi gjendjen dhe ndryshimet që kanë ndodhur në tregun e sigurimeve gjatë vitit 2020, si dhe mbi aktualitetet dhe sfidat me të cilat është ballafaquar Agjencia për Mbikëqyrje të Sigurimeve do të gjeni në raportet vjetore.

Me respekt,

Kërste Shajnoski,



Kryetar i Këshillit të Ekspertëve

24.8.2021



AGJENCIA E MBIKËQYRJES TË SIGURIMEVE

RAPORTI VJETOR

MBI PUNËN E AGJENCISË SË MBIKËQYRJES
SË SIGURIMEVE PËR VITIN 2020

1. HYRJJE

Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve (në tekstin e mëtejshëm "AMS") është trup rregullator i pavarur i cili kryen autorizime publike, të përcaktuara me Ligjin për Mbikëqyrje të Sigurimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/2002, 98/2002, 79/2007, 88/2008, 67/2010, 44/2011, 112/2011, 188/2013, 30/2014, 43/2014, 112/2014, 153/2015, 192/2015, 23/2016, 83/2018 dhe 198/2018) dhe ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 101/2019 dhe 31/2020), dhe me Ligjin për Sigurim të Detyrar në Qarkullim nr. 88/2005, 70/2006, 81/2008, 47/2011, 135/2011, 112/2014 dhe 145/2015 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 220/2019).

Në kuadër të kompetencave dhe autorizimeve të veta AMS-ja kujdeset për ligjshmërinë dhe efikasitetin e tregut të sigurimit me qëllim që të mbrohen të drejtat e pronarëve dhe përdoruesve të sigurimit.

AMS-ja i ka këto kompetenca:

- Zbaton mbikëqyrje të shoqërive të sigurimeve, shoqërive të brokerimit në sigurime, shoqërive të përfaqësimit në sigurime, bankave të cilat ushtrojnë aktivtete të përfaqësimit në sigurime, brokerëve të sigurimit dhe përfaqësuesve në sigurime, të personave juridikë që lidhen me shoqëritë e sigurimeve dhe të Byrosë Nacionale për Sigurime;
- Miraton akte nënligjore për zbatim të Ligjit për Mbikëqyrje të Sigurimeve dhe jep propozime për miratim të ligjeve nga fusha e sigurimeve;
- Vendos për dhënien apo revokimin e lejeve, dhënien apo revokimin e pëlqimeve, dhënien apo revokimin e licencave;
- Shqipton masa të mbikëqyrjes;
- Bashkëpunon me institucionet dhe trupat relevantë të huaj dhe nga vendi dhe është anëtare e Asociacionit Ndërkombëtar të Supervizorëve të Sigurimeve;
- E nxit zhvillimin e sigurimeve dhe e zhvillon ndërgjegjësimin e opinionit mbi rolin e sigurimeve dhe mbi rolin e mbikëqyrjes të sigurimeve përmes aktiviteteve të edukimit financiar dhe përfshirjes financiare.

Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve është anëtare e Asociacionit Ndërkombëtar të Supervizorëve të Sigurimeve (IAIS) që nga viti 2009. IAIS është organ ndërkombëtar përgjegjës për promovimin e mbikëqyrjes efektive dhe globale të qëndrueshme të tregut të sigurimeve, në mënyrë që të zhvillojë dhe mirëmbajë një treg sigurimesh të ndershëm, të qëndrueshëm dhe transparent për përfitimin dhe mbrojtjen e policëmbajtësve të sigurimit dhe për të kontribuar në stabilitetin financiar global.

2. MENAXHIMI INSTITUCIONAL

2.1. Puna e Këshillit të Ekspertëve

Organi i menaxhimit dhe udhëheqjes së AMS-së është Këshilli i Ekspertëve, i cili përbëhet nga Kryetari i Këshillit dhe katër anëtarë. Kryetari dhe katër anëtarët e Këshillit të Ekspertëve të AMS-së i emëron Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut me Propozim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Përbërja e Këshillit të Ekspertëve:

- dr. Kërste Shajnoski, i angazhuar profesionalisht me orar të plotë pune, kryetar i Këshillit të Ekspertëve
- dr. Sulejman Ahmedi, anëtar i angazhuar profesionalisht në Këshillin e Ekspertëve, me orar të plotë pune,
- Zllate Simonovski, anëtar i angazhuar profesionalisht në Këshillin e Ekspertëve, me orar të plotë pune,
- dr. Igor Ivanovski, anëtar i Këshillit të Ekspertëve, i cili nuk është i angazhuar profesionalisht,
- Aleksandra Kokaroska, anëtare e Këshillit të Ekspertëve, e cila nuk është e angazhuar profesionalisht.

Këshilli i Ekspertëve është organ kolektiv i cili punon me seanca dhe merr vendime me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve. Gjatë vitit 2020 Këshilli i Ekspertëve ka mbajtur rregullisht seanca ku ka vendosur për çështje në kompetencat e tij. Këshilli i Ekspertëve në vitin 2020 ka mbajtur 22 seanca.

AMS-ja për punën e vet mban përgjegjësi para Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Kuvendi miraton: Planin financiar të AMS-së, Raportet financiare të rishqyrtuara nga një auditues i pavarur i autorizuar, Raportin vjetor për punën e AMS-së dhe Raportin vjetor mbi gjendjen dhe lëvizjen e tregut të sigurimeve.

2.2. Misioni dhe vizioni

Misioni dhe Vizioni i AMS-së synon krijimin dhe mbajtjen e një tregu të sigurt, stabil dhe transparent të sigurimeve në dobi dhe në mbrojtje të të drejtave të të siguruarve, kontributin mbi rritjen ekonomike dhe sigurimin e stabilitetit të sistemit financiar.

2.3. Vlerat

Parimet dhe vlerat themelore nga të cilat udhëhiqet AMS-ja janë: Përgjegjësia, Profesionalizmi, Ndërgjegjësimi dhe Transparenca.

2.4. Strategjia për menaxhim me rreziqet

Strategjia për menaxhimin me rreziqet si mjet që ndihmon të parashihen ngjarjet e papërshtatshme dhe të reagohet ndaj tyre, përkatësisht të jepen procedurat e kontrollit të brendshëm dhe resurset për funksionet kyçe dhe rreziqet që lidhen me to, kontribuon që AMS-ja të ballafaqohet me sukses me rreziqet.

2.5. Planifikimi i punës së AMS-së

Këshilli i Ekspertëve i AMS-së miraton akte dhe dokumente strategjike për punën e AMS-së bazuar në planifikim, duke marrë parasysh faktorët e brendshëm dhe të jashtëm dhe ndikimin e tyre në arritjen e objektivave të AMS-së.

Aktivitetet e planifikuara AMS-ja i përcakton përmes miratimit të :

- Planit të punës,
- Planit vjetor për mbikëqyrje në terren,
- Planit financiar,
- Planit për punën në arkiv.
- Planit strategjik dhe dokumente dhe akte të tjera të brendshme.

2.6. Auditimi i brendshëm

Aktiviteti i auditimit të brendshëm në AMS, duke shfrytëzuar qasje sistematike, të disiplinuar dhe të bazuar në rreziqet, kontribuon në përmirësimin e proceseve të udhëheqjes, menaxhimit me rrezikun dhe mbajtjen e kontrolleve efektive në ballafaqimin me rreziqet në menaxhimin, punën dhe sistemet informuese të AMS-së, në raport me:

- Realizimin e qëllimeve strategjike të AMS-së;
- Harmonizimin e ligjeve, dispozitave, procedurave dhe marrëveshjeve;
- Efektivitetin dhe efikasitetin e punës së programeve;
- Besueshmërinë dhe integritetin e informacioneve financiare dhe operative;
- Mbrojtjen e mjeteve.

2.7. Organizimi dhe financimi i AMS-së

Në përputhje me Rregulloren për organizimin e brendshëm të vendeve të punës, të punësuarit janë shpërndarë në 2 drejtori të pavarura që mbajnë përgjegjësi drejtpërdrejt para kryetarit dhe Këshillit të Ekspertëve, 3 shërbime profesionale dhe 9 drejtori në kuadër të shërbimeve profesionale.

Puna e AMS-së financohet nga kompensimet që i paguajnë shoqëritë e sigurimeve, shoqëritë e brokerimit në sigurime, shoqëritë për përfaqësim në sigurime, bankat të cilat ushtrojnë aktivitete të përfaqësimit në sigurime dhe personat e tjerë mbi të cilët AMS-ja kryen supervizion, të përcaktuara me Listën e Tarifave për përmbajtjen dhe vlerën e kompensimeve dhe detyrimeve që i paguhen Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve dhe për afatet e pagimit, në përputhje me Ligjin e Mbikëqyrjes të Sigurimeve.

2.8. Përgjegjësia shoqërore korporative

Në punën e vet AMS-ja i respekton parimet dhe principet e përgjegjësisë shoqërore korporative si përmbledhje të të gjitha pritjeve ekonomike, juridike, etike që shoqëria i ka ndaj subjekteve juridike. Në këtë drejtim, AMS-ja i ka ndërmarrë aktivitetet vijuese:

- jep mundësi për punë praktike për nxënësit në arsimin e mesëm dhe për studentët,
- merr pjesë në aksione humanitare etj.

3. AKTIVITETE TË REALIZUARA NË PERIUdhËN E RAPORTIT SIPAS FUSHAVE

3.1. Legjislativa dhe Licencimi

Në suazat e kompetencave në fushën e legjislativës dhe licencimit, AMS-ja në vitin 2020 i ka zbatuar këto aktivitete:

3.2. Rregullore të miratuara

- Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për mënyrën, procedurën dhe kushtet për mbajtje të trajnimit dhe dhënies së provimit profesional për ushtrimin e aktiviteteve të përfaqësimit në sigurime;
- Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për mënyrën, procedurën dhe kushtet për mbajtje të trajnimit dhe dhënies së provimit profesional për broker në sigurime;
- Rregullorja për formën dhe përmbajtjen e Urdhër-pagesës për kundërvajtje;
- Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për llojet dhe përmbajtjen e zërave që do të merren parasysh gjatë përlllogaritjes së kapitalit të shoqërive të sigurimeve dhe/ose risigurimeve;
- Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së llojeve dhe karakteristikave të mjeteve të cilat i mbulojnë provigjonet teknike dhe mjetet të cilat e mbulojnë provigjoniin matematikor, si dhe plasimin e detajuar dhe kufizimin e atyre investimeve si dhe vlerësimin e tyre;
- Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për mënyrën e vlerësimit të zërave nga bilanci dhe përgatitjen e bilanceve afariste;
- Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për përmbajtjen minimale të regjistrave/evidencave dhe mënyrën e raportimit, rezervimit dhe likuidimit të dëmeve nga shoqëritë e sigurimeve;
- Rregullorja për kërkesat minimale për pranimin, trajtimin, rezervimin dhe pagesën e kërkesave për kompensim të dëmit dhe/ose shumën e siguruar në mënyrë që të mbrohen më mirë të drejtat e policëmbajtësve;
- Rregullorja për standardet minimale të sistemeve të informacionit të shoqërive të sigurimeve, shoqërive të brokerimit në sigurimeve dhe shoqërive të përfaqësimit në sigurime;
- Rregullorja për mënyrën dhe procedurën e mbajtjes të provimit profesional të nevojshëm për marrjen e lejes së punës si aktuar i autorizuar;
- Rregullorja për ndryshimin e Rregullores për dokumentacionin e nevojshëm për marrjen e licencës për broker në sigurime;
- Rregullorja për ndryshimin e Rregullores për dokumentacionin e nevojshëm për marrjen e licencës për përfaqësues në sigurime;
- Rregullorja për ndryshimin e Rregullores për mënyrën, procedurën dhe kushtet për mbajtjen e trajnimit dhe dhënien e provimit profesional për ushtrimin e aktivitetit të brokerimit në sigurime;
- Rregullorja për ndryshimin e Rregullores për mënyrën, procedurën dhe kushtet për mbajtjen e trajnimit dhe dhënien e provimi profesional për ushtrimin e aktivitetit të përfaqësimit në sigurimeve;
- Rregullorja për ndryshimin e Rregullores për mënyrën, procedurën dhe dokumentacionin e kërkuar për marrjen e pëlqimit;
- Rregullorja për standardet minimale për llogaritjen e provigjoneve teknike.

3.3. Leje dhe miratime të dhëna

- 3 leje për vendosjen e klasës së re të sigurimit;
- 2 leje për ushtrimin e aktiviteteve të brokerimit në sigurime;
- 15 miratime për ushtrim të funksionit anëtar në organ të menaxhimit;
- 8 miratime për ndryshim të Statutit të shoqërisë së sigurimeve;
- 17 miratime për shoqëritë për auditim të raporteve financiare dhe raporteve të konsoliduara financiare të shoqërive të sigurimit për vitin 2020;
- 3 miratime për fitimin e pjesëmarrjes së kualifikuar në shoqërinë e sigurimit;
- 4 miratime për pjesëmarrje të kualifikuar në shoqërinë e brokerimit të sigurimeve;
- 1 miratim për pjesëmarrje të kualifikuar në shoqëri për përfaqësim në sigurime;

- 6 miratime për ndryshim të selisë së shoqërisë së sigurimeve;

3.4. Licenca të dhëna

- janë dhënë 33 licenca për brokerë sigurimi,
- 204 licenca për përfaqësues në sigurime.

3.5. Leje dhe licenca të revokuara

- përfundimi i 1 leje për ushtrimin e aktiviteteve të përfaqësimit në sigurime; dhe
- janë revokuar 31 licenca për përfaqësues në sigurime, personave fizikë.

3.6. Trajnime të organizuara

Për përfundimin e kapaciteteve për ndërmjetësim në tregun e sigurimeve, në vitin 2020 AMS-ja zbatoi një cikël të trajnimeve për brokerë sigurimi dhe për përfaqësues në sigurime.

4. ZBATIMI I MBIKËQYRJES

AMS-ja zbaton mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimeve, shoqërive të brokerimit në sigurime, shoqërive të përfaqësimit në sigurime dhe Byrosë Nacionale për Sigurimet, në përputhje me Ligjin për Mbikëqyrje të Sigurimeve, Ligjin për Sigurim të Detyrueshëm në Qarkullim dhe dispozitave të tjera relevante. AMS-ja ka kompetencë të zbatojë supervizion/mbikëqyrje edhe të personave fizikë të cilët ushtrojnë aktivitete brokerimi në sigurime dhe aktivitete të përfaqësimit në sigurime. Gjithashtu ka autoritetin të mbikëqyrë zbatimin e masave dhe veprimeve për të parandaluar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit në përputhje me Ligjin për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe të Ardhurave të Tjera nga Krimi dhe Financimi i Terrorizmit.

Mbikëqyrja zbatohet nëpërmjet mbikëqyrjes permanente off-site të punës së shoqërive të sigurimeve dhe të subjekteve të tjera të sigurimeve nëpërmjet mbledhjes, analizimit dhe verifikimit të raporteve dhe informacioneve të dorëzuara, si edhe nëpërmjet mbikëqyrjes në terren (të tërësishëm apo të pjesshëm), mbikëqyrjes të punës së subjekteve të sigurimeve me qëllim që të vlerësohet siguria, stabiliteti, rrezikshmëria dhe harmonizimi i punës së subjekteve.

Në kushtet e një pandemie globale të deklaruar në vitin 2020, Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve i përshtati aktivitetet e saj në rrethanat e reja dhe më pas mori disa masa për të siguruar një treg të qëndrueshëm të sigurimeve dhe për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e mbajtësve të policave të sigurimit. Një pjesë e masave kishin për qëllim lehtësimin e punës në kushte emergjente dhe forcimin e mbështetjes së shoqërive në segmentin e menaxhimit të pasojave negative të koronavirusit (COVID 19) duke çliruar disa nga rezervat e tyre. Në të njëjtën kohë u lejoi shoqërive një periudhë kohe shtesë për të korigjuar vlerën e të arkëtueshmeve. Në mënyrë që të mbrojnë të drejtat dhe interesat e të siguarve dhe trajtimin cilësor të dëmeve në kushtet e punës në gjendje të jashtëzakonshme, AMS-ja caktoi një afat shtesë për raportimin dhe regjistrimin e dëmeve në shoqëri dhe rekomandoi që shoqëritë që kanë realizuar fitim të përmbahen ose distancohen nga rishpërndarja e fitimeve.

Përveç kësaj, AMS-ja përmes informimit dhe raportimit në kohë i edukoi të siguarit për të drejtat e tyre që burojnë nga kontrata e sigurimit veçanërisht në zgjidhjen e dëmit dhe pagimin e kompensimit dhe mundësinë për të përdorur mekanizmin e parashtrimit të ankimit nëse nuk janë të kënaqur me mënyrën e zgjidhjes së dëmit.

4.1. Mbikëqyrja në terren

Në përputhje me Planin për mbikëqyrjen për vitin 2020, AMS-ja ka zbatuar 2 mbikëqyrje në terren tek shoqëritë e sigurimeve. Për shkak të situatës globale dhe pandemisë së deklaruar me Covid-19,

AMS-ja përmes riorganizimit shtesë të burimeve të saj njerëzore, vazhdoi të zbatojë mbikëqyrje off-site dhe për disa nga mbikëqyrjet e planifikuara në terren, përfshirë edhe në fushën e pastrimit të parave, u vendos që ato të transferoheshin në vitin e ardhshëm, 2021.

4.2. Mbikëqyrja off-site

Në bazë të konstatimeve nga zbatimi i mbikëqyrjes off-site, AMS-ja ka shqiptuar 26 masa të mbikëqyrjes prej të cilave 21 urdhëresa për eliminimin e paligjshmërive dhe 5 masa plotësuese të mbikëqyrjes ndaj shoqërive të sigurimeve. Për shkak të parregullsive të identifikuara në ushtrimin e aktivitetit të cilat paraqesin kundërvajtje, AMS-ja ka realizuar 12 procedura të zgjidhjes apo shlyerjes duke dorëzuar urdhër-pagesa për kundërvajtje.

4.3. PIKËPAMJE DHE QARKORE

Në fushën e mbikëqyrjes, për të forcuar procesin mbikëqyrës, u përgatitën 9 shkresa qarkore që përmbajnë pikëpamjet dhe udhëzimet e AMS-së për çështje të caktuara në fushën e sigurimeve.

5. BASHKËPUNIMI

Ushtrimi e punëve në kompetencë të AMS-së si dhe nevoja e ndjekjes së trendeve të reja nga profili, nxitja e rritjes dhe zhvillimit të tregut kërkon bashkëpunim me organet dhe institucionet vendase kompetente, me institucionet rajonale dhe ndërkombëtare rregullatore.

Përforcimi i bashkëpunimit midis rregullatorëve vendas është i rëndësishëm dhe lidhet me shkëmbimin dhe përdorimin e informacioneve dhe të dhënave, sigurimin e trajnimit të përbashkët dhe shkëmbimin e përvojave. Bashkëpunimi me Sektorin për Sistemin Financiar në Ministrinë e Financave zhvillohet për çështje mbi normativën nga fusha e sigurimeve. Bashkëpunimi me Bankën Popullore zhvillohet në suazat e shkëmbimit të të dhënave për përpilim të raportit mbi stabilitetin financiar, edukimin financiar dhe inkluzionin financiar, si dhe shkëmbimin e vazhdueshëm të përvojës dhe praktikave në procesin e zbatimit të supervizionit. Në drejtim të harmonizimit të legjislacionit vendas me atë të Bashkimit Evropian, ASM-ja bashkëpunon me Sekretariatit për Çështje Ekonomike duke dhënë të dhëna mbi procesin e tregut të sigurimit me qëllim të përgatitjes së raporteve mbi përparimin e shtetit në fushën e tregut dhe konkurrencës së brendshme dhe mbi çështjet ekonomike-financiare dhe statistikën.

Me qëllim ndjekjen e gjendjes të sistemit të financimit dhe aftësisë më të mirë për menaxhimin e sfidave, vaçanërisht në rrethana të cilat na i imponoi kriza e koronës, rregullatorët e financave në vitin 2020 nënshkruan Memorandum për bashkëpunimin ndërinstitucional. Me këtë Memorandum, nënshkruer i të cilit është edhe AMS-ja, rregullatorët financiarë përcaktojnë domosdoshmërinë e forcimit të koordinimit dhe individualisht, në kohë dhe në mënyrë efektive i identifikojnë rreziqet e sistemit dhe veprojnë të rakorduar në mënyrë që ato të parandalohen dhe mos kenë ndikim në sistemin financiar.

6. ORGANIZIMI I EVENTEVE

Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve, më 1 nëntor të vitit 2020 shënoi 11-vjetorin e themelimit të saj dhe funksionimit të suksesshëm. Me këtë rast, u mbajt një takim me përfaqësuesit e industrisë së sigurimeve me temën “Sfidat e AMS-së dhe situata në tregun e sigurimeve në RMV-së”. Në takimin i cili për shkak të pandemisë u mbajt on-line, AMS-ja theksoi sfidat me të cilat përballet si dhe planet dhe pritjet e ardhshme në fushën e sigurimeve dhe mbikëqyrjes së sigurimeve, duke theksuar qartë angazhimin e saj për forcimin e menaxhimit korporativ në shoqëri, transparencës më të madhe dhe forcimin e besimit të opinionit në sektorin e sigurimeve. Në takim, para të pranishëmve nga industria e sigurimeve, u prezantua edhe punimi studimor i vlerësuar me çmim për vitin 2020 nga fusha e menaxhimit me rreziqet.

Për zhvillimin e mëtejshëm të tregut financiar, AMS-ja në bashkëpunim me Bursën e Aksioneve të Maqedonisë realizuan një seminar virtual për shoqëritë e sigurimeve si investitorë institucionale

dhe pjesëmarrës në tregun financiar dhe posaçërisht në tregun e kapitalit.

7. EDUKIMI DHE NDËRTIMI I KAPACITETEVE

Aftësimi i kuadrit të AMS-së është parakusht për kryerjen cilësore, efikase dhe në kohë të punëve dhe detyrave nën kompetencë të saj dhe për këtë arsye AMS-ja investon vazhdimisht në potencialin e saj njerëzor. Në vitin 2020, për shkak të rrethanave të pandemisë globale dhe kufizimeve që u vendosën kryesisht për mbrojtjen e shëndetit publik, nuk kishte kushte për zbatimin gjithëpërfshirës të programit të planifikuar për nevojat e stafit dhe kryesisht trajnimi dhe azhurnimi i njohurive u krye virtualisht duke vizituar programe edukative, seminare në Asociacionin Ndërkombëtar të Supervizionit të Sigurimeve (IAIS), Trupin Evropian për Supervizion (EIOPA), Bankën për Rregullim Ndërkombëtar (BIS), Rrjetin Ndërkombëtar për Arsim Financiar dhe Edukim (OECD-INFE) dhe institucione dhe organizata të tjera relevante.

Në kuadër të anëtarësimit në Asociacionin Ndërkombëtar të Supervizorëve të Sigurimeve (IAIS), AMS-ja me kontributin dhe ekspertizën e saj mori pjesë në punën e këtij trupi, përmes studimeve kërimore, on-line seminareve, raportimit lidhur me masat e marra për trajtimin e krizës së koronës dhe punën në kushte emergjente. Gjithashtu mori pjesë, në konferencën vjetore on-line të IAIS-së ku ndër të tjera u diskutua edhe për sfidat e mbikëqyrësve për punën në kushte të pandemisë globale.

Për të mbikëqyrur më mirë grupet e sigurimeve që janë të pranishme në disa shtete anëtare të BE-së dhe vendet që janë në faza të ndryshme në proceset e anëtarësimit në Bashkimin Evropian, AMS-ja mori pjesë në punën e kolegjeve mbikëqyrëse.

8. MBROJTA E KONSUMATORËVE, EDUKIMI FINANCIAR DHE INKLUZIONI FINANCIAR

Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve, brenda kompetencave të saj ligjore për zhvillimin e tregut të sigurimeve dhe ngritjen e ndërgjegjësimit publik për rolin e sigurimeve dhe mbikëqyrjes së sigurimeve, vepron në mënyrë të integruar në fushën e edukimit financiar, përfshirjes financiare dhe mbrojtjes së të drejtave të të siguruarve si segmente plotësuese. Për shumë vite, AMS-ja ka kryer aktivitete në fushën e edukimit financiar duke përfshirë opinionin e gjerë me një fokus të veçantë tek të rinjtë.

Në kuadër të bashkëpunimit me Asociacionin e Bankave të Maqedonisë, AMS-ja mbështeti projektin - Kuizi Evropian i Parave, i destinuar për nxënësit nga 13 deri në 15 vjeç. Për nevojat e kuizit, u përgatitën pyetje në fushën e sigurimeve dhe mbikëqyrjes së sigurimeve, si dhe literaturë profesionale dhe tekste edukative.

AMS-ja nënshkroi Memorandum Bashkëpunimi me Organizatën e Konsumatorëve të Maqedonisë në mënyrë që të forcojë bashkëpunimin e ndërsjellë për zbatimin e projekteve dhe aktiviteteve për mbrojtjen e policëmbajtësve, edukimin financiar, afrimin dhe aksesin e tyre në produktet dhe shërbimet e sigurimeve.

Në mënyrë që të inkurajojë mendimin shkencor dhe të kontribuojë në rritjen e numrit dhe cilësisë së punimeve shkencore të aplikuara në fushën e menaxhimit të rrezikut dhe sigurimeve, AMS-ja çdo vit shpall konkurs për dhënien e çmimit vjetor për punim studimor në fushën e menaxhimit të rrezikut dhe sigurimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Ndërsa, për të rritur ndërgjegjësimin e të rinjve për rëndësinë dhe rolin e sigurimeve, AMS-ja shpall konkurs për nxënësit e arsimit fillor dhe të mesëm me rastin e Ditës së Sigurimeve - 1 Nëntori, me tema në fushën e sigurimeve.

AMS-ja mori pjesë në shënimin e manifestimit kombëtar "Ditët e edukimit financiar", në koordinim dhe organizim të Trupit Koordinues të Institucioneve Rregullatore për Edukimin Financiar dhe Përfshirjen Financiare. Për shkak të kushteve të vendosura nga pandemia, "Ditët e edukimit Financiar" u organizuan virtualisht. Brenda këtij eventi, AMS-ja përgatiti disa përmbajtje edukative në fushën e sigurimeve dhe mbikëqyrjes së sigurimeve si: kuiz, thirrje publike për pjesëmarrje në leksione edukative, realizimin e anketës të kënaqshmërisë të përdoruesve, përgatitja dhe promovimi i teksteve dhe broshurave të reja arsimore-edukative, etj.

Për mbrojtjen e të drejtave të të siguruarve dhe përdoruesve të prodhimeve dhe shërbimeve të sigurimeve, AMS-ja ka proceduruar lidhur për ankimimet e marra kundër subjekteve të sigurimeve. Në vitin 2020 në AMS-ja janë dorëzuar 88 ankimime, prej të cilave:

- 71 ankimime janë zgjidhur;
- 12 ankimime janë pa bazë për të vepruar;
- 2 ankimime janë në procesin e zgjidhjes; dhe 2 janë ankimime të tërhequra.

Gjithashtu, në mënyrë që të sigurohet stabiliteti i sektorit të sigurimeve dhe mbrojtje më e madhe e të siguruarve në kushtet e pandemisë të shpallur në vitin 2020, AMS-ja miratoi një paketë me disa masa për të siguruar transparencë më të madhe në operacionet e shoqërive dhe për të krijuar besim te sektori i sigurimeve.

9. AKTIVITETE PROJEKTORE

Në kuadër të projektit rajonal nën kujdesin e Ministrisë së Financave të Hollandës dhe INFE-OECD-së, AMS-ja si pjesë e Trupit Koordinues të Institucioneve Rregullatore për Edukimin Financiar dhe Përfshirjen Financiare me ekspertizën e tij kontribuoi në përgatitjen e draft-dokumentit të parë Strategjia për Edukimin Financiar dhe përfshirjen financiare. Ai gjithashtu mori pjesë në realizimin e e investigimeve dhe analizave nga INFE-OECD për të matur nivelin e edukimit dhe arsimimit financiar të popullatës madhore apo të rritur.

10. INFORMIMI I PUBLIKUT DHE TRANSPARENCA

Në bazë të Ligjit për akses të lirë tek informacionet me karakter publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.101/2019), në AMS janë dorëzuar pesë kërkesa për akses të lirë tek informacionet me karakter publik dhe u është dhënë përgjigje pozitive në afatin e përcaktuar ligjor. Në bazë të Ligjit për mbrojtje të denoncuesve/informatorëve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 196 më 10.11.2015) dhe (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 257/2020, në AMS është dorëzuar në fletëparaqitje për denoncues dhe është dhënë përgjigje në afatin e përcaktuar me ligj.

Me qëllim të transmetimit në kohë të informacionit dhe forcimit të praktikave të komunikimit me të gjitha palët e interesuar, AMS-ja vepron përmes faqes së saj të internetit, portalit edukativ dhe rrjeteve sociale si dhe duke mbajtur takime konsultative publike sipas nevojës, dhe takime për të raportuar mbi progresin lidhur me aktivitetet dhe projektet e AMS-së .

Për të rritur cilësinë e punës së saj, AMS-ja mat kënaqshmërinë e palëve të interesuara - klientëve përmes sondazheve elektronike dhe përmes mekanizmit të paraqitjes me shkrim të ankesave apo lavdërimeve nga përdoruesit e shërbimeve.

AGJENCIA E MBIKËQYRJES SË SIGURIMEVE

Kryetari i Këshillit të Ekspertëve
Dr. Kërste Shajnoski

Numri 02-455/4
Shkup
31.03.2021



AGJENCIA E MBIKËQYRJES TË SIGURIMEVE

RAPORTI VJETOR

MBI GJENDJEN DHE LËVIZJEN NË
TREGUN E SIGURIMEVE NË VITIN 2020

1. HYRJA

Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve (në tekstin që vijon "AMS") është trup rregullator i pavarur dhe sovran në tregun e sigurimeve i cili ushtron autorizime publike të përcaktuara me Ligjin e Mbikëqyrjes të Sigurimeve dhe Ligjin për Sigurim të Detyruar në Qarkullim. AMS-ja ka për qëllim të kontribuojë në funksionimin e ligjshëm dhe efikas të tregut të sigurimeve në vend, në zhvillimin e vazhdueshëm të tij, në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të të siguruarve/policëmbajtësve, si edhe në përparimin e stabilitetit financiar në vend.

Në fund të vitit 2020 në tregun e sigurimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut operojnë aktivisht 16 shoqëri sigurimesh, prej të cilave 11 shoqëri ushtrojnë aktivitetin e sigurimeve jo-jetë, kurse 5 sigurime të jetës. Në sektorin e ndërmjetësimit, në fund të vitit 2019 aktive janë 40 shoqëri brokerimi në sigurime, 10 shoqëri për përfaqësim në sigurime dhe 7 banka të cilat ushtrojnë aktivitetin e përfaqësimit në sigurime.

Në vitin 2020 është realizuar primi i shkruar bruto (në tekstin që vijon "PSHB") në shumë të përgjithshme prej 10,06 miliarda denarësh, që përbën një ulje prej 4,89% në raport me PSHB-në e realizuar në vitin 2019 (2019: 10,58 miliarda denarë). Në pjesën e sigurimit jo-jetë është realizuar PSHB në shumë prej 8.32 miliarda denarësh (2019: 8.75 miliarda denarë), përkatësisht ulje prej 4.88% në krahasim me vitin 2019. Njëkohësisht, te sigurimi i jetës është realizuar PSHB-ja në shumë prej 1.74 miliarda denarësh (2019: 1.83 miliarda denarë), që përbën një ulje prej 4.93%.

Shoqëritë e Sigurimeve më 31.12.2020 disponojnë mjete në një shumë prej 25.67 miliarda denarësh, që shënojnë rritje prej 7.34% në raport me vitin e kaluar (2019: 23.92 miliarda denarë). Kapitali i përgjithshëm i llogaritur i shoqërive të sigurimeve shënon rritje prej 5.53% në krahasim me vitin 2019 dhe arrin 7.01 miliarda denarë. Margjina e solvencës ose aftësisë paguese, si indikator kryesor për vlerësim të stabilitetit të sektorit të sigurimeve është 1.64 miliarda denarë, kështu që kapitali i sektorit të sigurimeve është 4.3 herë mbi nivelin e margjinës së aftësisë paguese.

Gjatë vitit 2020, sektori i sigurimeve realizoi fitim me vlerë prej 456.81 milionë denarësh. Gjatë kësaj, shoqëritë e sigurimeve jo-jetë realizuan fitim prej 273.81 milionë denarësh, kurse, shoqëritë e sigurimeve të jetës realizuan fitim për tatim prej 177.86 milionë denarësh.

Në fushën e normativës ligjore në vitin 2019 janë miratuar: ndryshime në Ligjin për Mbikëqyrje të Sigurimeve; 3 ndryshime në tashmë aktet nënligjore aktuale dhe 3 akte nënligjore të reja.

2. KORNIZA LIGJORE

Ligji për Mbikëqyrje të Sigurimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/02, 98/02, 79/07, 88/08, 67/10, 44/11, 112/11, 188/13, 30/14, 43/14, 112/14, 153/15, 92/15, 23/16, 83/18 dhe 198/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 101/19 dhe 31/20), Ligji për Sigurim të Detyrueshëm në Qarkullim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 88/05, 70/06, 81/08, 47/11, 135/11, 112/14 dhe 145/15 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 220/19), Ligji për Sigurime Vullnetare Shëndetësore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/12 dhe 192/15), Ligji për Pagim të Pensioneve dhe Kompensimeve Pensionale në Fushën e Sigurimit Financiar Kapital të Pensionit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 11/12, 147/15 dhe 30/16) dhe Ligji për Parandalim të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 120/18 dhe 317/2020 janë korniza ligjore themelore e cila i rregullon kushtet dhe mënyrën e ushtrimit të aktivitetit të ndërmjetësimit në sigurime dhe zbatimin e mbikëqyrjes mbi aktivitetit të shoqërive të sigurimeve, shoqërive të brokerimit të sigurimeve dhe shoqërive të përfaqësimit në sigurime.

Kornizën më të gjerë ligjore e përfaqësojnë Ligji për Marrëdhënie Obligative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 18/01, 4/02, 5/03, 84/08, 81/09, 161/09 dhe 123/13) në pjesën që lidhet me marrëveshjet e sigurimeve dhe Ligji për Shoqëritë Tregtare ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 28/04, 84/05, 25/07, 87/08, 42/10, 48/10, 24/11, 166/12, 70/13, 119/13, 120/13, 187/13, 38/14, 41/14, 138/14, 88/15, 192/15, 6/16, 30/16 dhe 61/16, 64/18 dhe 120/18). Ligji për Mbikëqyrje të Sigurimeve i inkorporon parimet dhe standardet e sigurimeve të Asociacionit Ndërkombëtar të Supervizorëve të Sigurimeve (IAIS), si dhe direktivat për sigurime të Bashkimit Evropian (BE). Me këtë ligj rregullohet themelimi dhe puna e shoqërive të sigurimeve, menaxhimi me rreziqet, roli i aktuarëve të autorizuar, mbajtja e librave të biznesit dhe raporteve, auditimi i brendshëm dhe i jashtëm, përfaqësimi dhe ndërmjetësimi në sigurimet, supervizioni ose mbikëqyrja e shoqërive të sigurimeve, puna e AMS-së, zbatimi i mbikëqyrjes dhe procedura për marrjen e aktvendimeve nga AMS-ja, bashkëpunimi me organet dhe trupat mbikëqyrës të BE-së, si dhe dispozitat ndëshkuese.

Në vitin 2020 është miratuar Ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Mbikëqyrje të Sigurimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 31/20) me të cilin parashikohet që para hapjes së procedurës kundërvajtëse ose procedurës për shkelje të konfirmuara me këtë ligj. Agjencia autorit të shkeljes i jep propozim për zgjidhje me dhënien e një urdhër-pagese për shkelje. Në pajtim me Ligjin për Kundërvajte. Gjithashtu, me këto ndryshime, ndryshohet edhe vlera e një pjese të gjobave që janë parashikuar për shkelje/kundërvajte të caktuara të bëra sipas këtij ligji.

Sigurimi i Detyrueshëm në Qarkullim rregullohet me Ligjin e Sigurimit të Detyrueshëm në Qarkullim, i cili i rregullon kontratat e sigurimit të detyrueshëm, shumat minimale të sigurimit, afatet e raportimit dhe kompensimit të dëmeve nga shoqëritë e sigurimeve, përcaktimin e së drejtës për ndërmjetësim (ndërmjetësim), kompetencat e Fondit të Garancisë, ndryshimin e mënyrës së përcaktimit të tarifave të primit përmes funksionimit të Komisionit të Sigurimit të Auto-Përgjegjësisë dhe dispozitat ndëshkuese për shoqëritë e sigurimeve dhe Byronë Kombëtare të Sigurimeve. Ligji gjithashtu përcakton detyrimet që shoqëritë e sigurimeve të caktojnë përfaqësues të autorizuar për dëmet jashtë vendit në mënyrë që viktimat e aksidenteve të trafikut të kenë akses të lehtë dhe të shpejtë në paraqitjen e kërkesave për dëmet e shkaktuara nga automjetet e vendit jashtë tij, si dhe të krijojnë një Shërbim për Kompensim të Dëmeve, si garanci për viktimat e aksidenteve të trafikut jashtë vendit, që edhe nëse shoferi përgjegjës po drejtonte një automjet të pasiguar, dëmi do të trajtohet dhe paguhet në kohën e duhur. Disa nga këto dispozita tashmë kanë hyrë në fuqi, dhe disa do të hyjnë në fuqi nga momenti i fitimit të anëtarësimit të plotë të Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian.

Me Ligjin për sigurim vullnetar shëndetësor jepet mundësi ligjore dhe hapet një fushë e gjerë veprimi për shoqëritë e sigurimeve për oferta të pakove të shërbimeve shëndetësore të cilat janë përfshirë tashmë me sistemin e sigurimit të obligueshëm shëndetësor. Sigurimi shtesë shëndetësor siguron mbulim të shpenzimeve në emër të pjesëmarrjes me mjete personale për shfrytëzim të

shërbimeve shëndetësore nga sigurimi shëndetësor i obliguar (participim), në përputhje me dispozitat e sigurimit të obliguar shëndetësor dhe mbrojtjes shëndetësore. Sigurimi privat shëndetësor mundëson mbulim të shpenzimeve për përdorim të shërbimeve shëndetësore për standard më të lartë të shërbimeve shëndetësore të cilat dalin nga sigurimi i obliguar shëndetësor, shpenzimet për mbulim të shërbimeve shëndetësore të përdorura në veprimtari shtesë, si dhe për përdorim të shërbimeve shëndetësore në institucionet shëndetësore jashtë rrjetit të institucioneve shëndetësore ku kryhet veprimtaria shëndetësore dhe te personat juridikë të cilët kryejnë përpunim, dhënie dhe servisim të mjeteve ortopedike dhe mjeteve të tjera ndihmëse.

Me Ligjin për pagim të pensioneve dhe kompensimeve pensionale nga fusha e sigurimit financiar pensional përfundoi rregullimi i sigurimit kapital financiar në Republikën e Maqedonisë së Veriut me rregullim të fazës së deakumulimit, përkatësisht me këtë Ligj rregullohen pagesat e pensioneve nga shtylla e dytë dhe kompensimet e pensionit nga shtylla e tretë. Në ligj në mënyrë të hollësishme rregullohen llojet e pagesave të pensioneve në shtyllën e dytë (tërheqje të programuara, anuitete të përjetshme dhe kombinimi i tyre), llojet e pagesave të kompensimeve të pensionit nga shtylla e tretë (tërheqje të programuara, anuitete, pagesa të njëfishta dhe të shumëfishta), karakteristika dhe rregulla për lloje të ndryshme të pagesave dhe mënyra dhe procedura e fitimit të së drejtës së pensionit në bazë të moshës, pension invalidi dhe pension familjar nga shtylla e dytë, si dhe procedurë për fitimin e së drejtës të kompensimit pensional nga shtylla e tretë. Në këtë Ligj rregullohet edhe se cilat institucione do të mund të bëjnë pagim të pensioneve dhe kompensimeve të pensioneve nga shtylla e dytë dhe e tretë - shoqëritë pensionale dhe shoqëritë për sigurim të jetës. Gjithashtu, për shkak të transparencës më të madhe të përzgjedhjes së pensionit nga shtylla e dytë dhe kompensimit të pensionit nga shtylla e tretë, u vendos Sistem elektronik i centralizuar i kotacionit nëpërmjet të cilit do të dorëzohen kërkesa për kotacione për lloje të ndryshme të pagesave dhe do të merren oferta nga shoqëritë pensionale dhe shoqëritë e sigurimeve.

Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit përcakton kompetencën e AMS-së për të zbatuar mbikëqyrje në tregun e sigurimeve i cili i nënshtrohet rregullimit të këtij Ligji, veçanërisht në pjesën e zbatimit të masave dhe veprimeve për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

3. TREGU I SIGURIMEVE NE REPUBLIKËN E MAQEDONISË SE VERIUT

3.1 SHOQËRITË E SIGURIMEVE

Gjatë vitit 2020, në tregun e sigurimeve operuan 16 shoqëri, nga të cilat 5 shoqëri sigurimesh operojnë me sigurime të jetës, ndërsa 11 të tjerat operojnë me sigurime jo-jetë. Vetëm një shoqëri, përveç aktivitetit të sigurimit jo-jetë, ka licencë për të ushtruar veprimtari të risigurimit. (Tabela Nr. 1).

Tabela nr. 1: Regjistri i shoqërive të sigurimeve

	Emërtimi i shoqërisë	Grupi i sigurimeve
1	SHA për sigurime dhe risigurime MAQEDONI – Shkup Inshurens Grup	Sigurimi jo-jetë dhe risigurimi
2	Triglav Osiguruvanje SHA Shkup	Sigurimi Jo-jetë
3	SAVA OSIGURUVANJE SHA Shkup	
4	SHA e Sigurimeve EUROINS Shkup	
5	SHA e Sigurimeve VINER – Viena Inshurens Grup Shkup	
6	SHA e Sigurimeve EUROLINK Shkup	
7	Grave osiguruvanje Jo-jetë SHA Shkup	
8	Shoqëria e Sigurimeve UNIKA SHA Shkup	
9	Grupacioni Kombëtar i Sigurimeve OSIGURITELNA POLISA SHA Shkup	
10	HALK OSIGURUVANJE SHA Shkup	
11	KROACIJA OSIGURUVANJE SHA- Shoqëri e Sigurimeve Jo-Jetë	
12	KROACIJA OSIGURUVANJE SHA- Shoqër e Sigurimeve Jo-Jetë	Sigurimi i jetës
13	GRAVE Osiguruvanje SHA Shkup	
14	SHA e Sigurimeve VINER Lajf – Viena Inshurens Grup Shkup	
15	Shoqëria e Sigurimeve UNIKA LAJF SHA Shkup	
16	TRIGLAV Osiguruvanje Jetë SHA Shkup	

Burimi: AMS

Shoqëritë e sigurimeve në fund të vitit 2020 kanë një numër të punësuarish prej 1,876 punëtorë që është një rënie prej 3,70% në numrin e fuqisë së punës së angazhuar të krahasuar me vitin 2019 (2019: 1,948).

3.1.1. Struktura e pronësisë

I Shoqëritë e sigurimeve janë kryesisht në pronësi nga persona të huaj juridikë në sektorin financiar (80,11%), të cilët janë pjesërisht ose tërësisht të pranishëm në 14 nga 16 shoqëritë e sigurimeve në treg (Tabela 2). Në këtë mënyrë, 12 shoqëri të sigurimeve janë pjesë e grupeve të sigurimeve me seli në vendet anëtare të BE-së, ndërsa dy shoqëri të sigurimeve janë plotësisht në pronësi të investuesve vendas.

Tabela nr. 2: Struktura e pronësisë së shoqërive të sigurimeve (përqindje)


	2020	2019	2018
1.Aksionerë të huaj	80.11%	79.51%	87.29%
1.1.Persona fizikë	0.33%	0.04%	0.05%
1.2.Persona juridikë jofinanciarë	0.00%	0.00%	0.00%
1.3. Institucione financiare	79.78%	79.46%	87.24%
2. Aksionarë vendas	19.86%	20.46%	12.67%
2.1. Persona fizikë	4.88%	4.97%	5.86%
2.2. Persona fizikë jofinanciarë	0.61%	0.91%	5.10%
2.3. Institucione financiare	14.37%	14.58%	1.72%
3. Shteti	0.03%	0.03%	0.04%
Gjithsej	100.00%	100.00%	100.00%

Burimi:AMS

3.1.2. Norma e zhvillimit

Treguesit themelorë me të cilët matet norma e zhvillimit të tregut të sigurimeve janë norma e penetrimit/depërtimit dhe norma e dendësisë.¹ Të dhënat për nivelin e penetrimit të sigurimeve në vitin 2020 dëshmuar se PSHB-ja e përgjithshme në vend merr pjesë me 1.52% në prodhimin bruto, që është i të njëjtit nivel me vitin e kaluar (2019: 1.52%). Ndërsa norma e dendësisë është 4.848 denarë për banor², që shënon rënie prej 4.85% në raport me vitin e kaluar (Grafiku nr. 1).

Grafiku nr. 1: Treguesit e zhvillimit të tregut të sigurimeve (milionë denarë; boshti i djathtë – përqindja)



Burimi: AMS, AMS, Enti Shtetëror i Statistikës dhe Ministria e Financave

Sektori i sigurimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut karakterizohet nga përqendrimi i ulët i cili është parakusht për konkurrencën funksionale të tregut. Indeksi Herfindal, i llogaritur përmes PSHB-së në vitin 2020 është 769.56 (2019: 792.42). Një rezultat i ngjashëm tregohet nga matja e indeksit përmes mjeteve/aseteve të shoqërive të sigurimeve në 838.02 në vitin 2020 (2019: 821.71).³

¹ Norma e penetrimit llogaritet si raport i primit të shkruar bruto dhe prodhimit bruto vendas, kurse norma e dendësisë llogaritet si raport i primit të shkruar bruto dhe numrit të banorëve në vend.

² E dhëna për numrin e banorëve është për vitin 2018, si e dhëna e fundit e shpallur për popullatën nga ESHS-ja.

³ Indeksi Herfindal llogaritet sipas formulës

$$HI = \sum_{i=1}^N (S_i)^2$$

ku S është pjesa e secilës shoqëri të sigurimeve në totalin e aktiveve (primi i shkruar bruto) i sektorit të sigurimeve, dhe n është numri i përgjithshëm i institucioneve në segmentin përkatës. Kur indeksi lëviz në intervalin prej 1,000 njësi në 1,800 njësi, niveli i përqendrimit të sektorit të sigurimeve konsiderohet i pranueshëm

Analizuar nga grupet e sigurimeve, një përqendrim më i lartë është i pranishëm në sigurimet e jetës, për shkak të numrit të vogël të shoqërive në këtë fushë. Në shoqëritë e sigurimeve të jetës indeksi Herfindal, i matur sipas PSHB-së, është 2,788.97 (2019: 3,157.74), ndërsa i matur sipas mjeteve /aseteve të shoqërisë, është 3,077.21 (2018: 3,083.30).

Në sigurimin jo-jetë treguesit tregojnë një përqendrim të ulët, me matjen përmes indeksit Herfindal sipas Primit të Shkuruar Bruto (PSHB-së) në vitin 2020 është 1,003.06 (2019: 1,020.43) dhe tregon një rënie krahasuar me vitin e kaluar, ndërsa i njëjti tregues i matur përmes mjeteve është 1,070.59 (2019: 1,058.79).

Treguesi CR5⁴, i matur përmes pjesëmarrjes në PSHB, te shoqëritë e sigurimeve jo-jetë, në vitin 2020 pati rënie me 56.86% (2019: 57.99%).

Ni vijim janë tabelat që tregojnë lëvizjet e indeksit Herfindal dhe treguesit e përqendrimit të pesë shoqërive të para të sigurimeve (CR5):

Tabela nr. 3: Indeksi herfindal dhe treguesi CR5 i matur sipas BPP

PSHB	2020		2019		2018	
	Herfindal	CR5	Herfindal	CR5	Herfindal	CR5
I gjithë sektori	769.56	47.03%	792.42	47.87%	830.10	50.46%
Jo-jetë	1,003.06	56.86%	1,020.43	57.99%	1,061.77	60.67%
Jetë	2,788.97	100.00%	3,157.74	100.00%	3,374.55	100.00%

Burimi:AMS


Tabela nr. 4: Indeksi Herfindal dhe treguesi CR5 i matur me mjete

Pasuritë	2020		2019		2018	
	Herfindal	CR5	Herfindal	CR5	Herfindal	CR5
I gjithë sektori	838.02	54.15%	821.71	53.50%	827.41	53.86%
Jo-jetë	1,070.59	60.69%	1,058.79	60.64%	1,097.37	62.15%
Jetë	3,077.21	100.00%	3,083.30	100.00%	3,085.58	100.00%

Burimi:AMS

Në fund të vitit 2020, në fushën e përqendrimit të tregut në pjesën e sigurimeve jo-jetë, 4 shoqëri të sigurimeve e kalojnë pragun e pjesëmarrjes me mbi 10% në totalin e PSHB-së. Kështu që, në tregun e sigurimeve në Republikën e Maqedonisë Veriore asnjë shoqëri nuk e kalon pragun e mbi 20% të pjesëmarrjes në treg (Grafiku nr. 2)

Grafiku nr. 2: Përqendrimi i tregut sipas Primit të Shkuruar Bruto në vitin 2020, në grupin e sigurimeve jo-jetë (përqindje)




Burimi:AMS

⁴ Treguesi CR5 është pjesëmarrja e 5 shoqërive të sigurimeve me pjesëmarrjen më të madhe në strukturën e përgjithshme.

Në grupin e sigurimeve të jetës, dy shoqëri të sigurimeve të jetës kanë një pjesëmarrje dominuese (Grafiku nr. 3)

Grafiku nr. 3: Përqendrimi i tregut sipas Primit të Shkruar Bruto në vitin 2020, në grupin e sigurimeve të jetës (përqindje)



Burimi:AMS

3.1.3. Primi i Shkruar Bruto

Primi i Shkruar Bruto në sigurime dhe risigurime tek shoqëritë e sigurimeve jo - jetë përfshin të gjitha shumat e primit që janë dakorduar (polica) në periudhën aktuale të kontabilitetit, pavarësisht nëse ato i referohen plotësisht ose pjesërisht periudhës së ardhshme, ndërsa në sigurimin e jetës primi i përgjithshëm i policës përfshin të gjitha primet e paguara deri në fund të periudhës së kontabilitetit.

Në vitin 2020 PSHB u realizua në shumën totale prej 10.06 miliardë denarë (Tabela 5), që është një rënie prej 4.89% krahasuar me PSHB-në të realizuar në vitin 2019 (2019: 10.58 miliardë denarë).

Tabela nr. 5: Primi i shkruar bruto nga klasat e sigurimeve (mijë denarë)

Klasat e sigurimeve	Primi i Shkruar Bruto (PSHB)		Dinamika 20/19	Pjesëmarrja në PSHB-në e përgjithshme	
	2020	2019		2020	2019
01. Sigurimi i aksidenteve	748,395	694,160	7.81%	7.43%	6.56%
02. Sigurimi shëndetësor	273,649	188,885	44.88%	2.72%	1.78%
03. Sigurimi i mjeteve motorike-kasko	823,735	838,236	-1.73%	8.18%	7.92%
05. Sigurimi i mjeteve ajrore-kasko	9,084	53,321	-82.96%	0.09%	0.50%
06. Sigurimi i mjeteve të lundrimit-kasko	1104	565	95.40%	0.01%	0.01%
07. Sigurimi i transportit të mallrave-kargo	84,696	81,562	3.84%	0.84%	0.77%
08. Sigurimi i pasurisë nga zjarri	768,207	751,603	2.21%	7.63%	7.10%
09. Sigurime të tjera të pasurisë	1,092,265	1,020,798	7.00%	10.85%	9.65%
10. Autopërgjegjësia	4,136,297	4,577,080	-9.63%	41.09%	43.25%
11. Sigurimi i përgjegjësisë të përdorimit të mjeteve ajrore	6,787	14,336	-52.66%	0.07%	0.14%
12. Sigurimi i përgjegjësisë të përdorimit të objekteve/mjeteve të lundrimit	2,709	3,063	-11.56%	0.03%	0.03%
13. Sigurime të tjera të përgjegjësisë	211,970	226,948	-6.60%	2.11%	2.14%
14. Kredi	25,158	12,927	94.62%	0.25%	0.12%
15. Sigurime të garancive	536	1241	-56.81%	0.01%	0.01%
16. Sigurimi i humbjeve financiare	64,478	67,203	-4.05%	0.64%	0.63%
17. Sigurimi mbrojtjes ligjore	8	5	60.00%	0.00%	0.00%
18. Sigurimi i asistencës turistike	76,325	220,692	-65.42%	0.76%	2.09%
19. Sigurimi i jetës	1,438,761	1,603,231	-10.26%	14.29%	15.15%
20. Sigurimi martesë-lindje	0	1,020	/	0.00%	/
21. Sigurimi i jetës kur rreziku i investimit përballohet nga i siguruari	301,742	226,538	33.20%	3.00%	2.14%
GJITHSEJ	10,065,906	10,583,414	-4.89%	100.00%	99.99%
GJITHSEJ JO-JETË	8,325,403	8,752,625	-4.88%	82.71%	82.70%
GJITHSEJ JETË	1,740,503	1,830,789	-4.93%	17.29%	17.30%

Burimi:AMS

Trendi negativ është i pranishëm në të dy segmentet e sigurimeve, duke pasur parasysh se në pjesën e sigurimit jo-jetë është realizuar PSHB në vlerë prej 8.32 miliardë denarë (2019: 8.75 miliardë denarë), ose 82.71% të PSHB-së totale të sektorit të sigurimeve dhe përfaqëson një ulje prej 4.88% krahasuar me vitin 2019. Gjatë vitit 2020, nuk u realizua asnjë prim i risigurimit (2019: 0).

Individualisht, krahasuar me vitin 2019, një rënie në PSHB u regjistrua në 8 kompani të sigurimeve jo-jetë (Tabela 6).

Tabela nr. 6: Primi i shkruar bruto sipas shoqërive të sigurimit jo-jetë (mijë denarë)

Nr.	Shoqëri sigurimesh	Primi i Shkruar Bruto (PSHB)		Dinamika	Pjesëmarrja në PSHB-në e përgjithshme	
		2020	2019		20/19	2020
1	Triglav	1,231,614	1,424,892	-13.56%	14.79%	16.28%
2	Eurolink	963.579	1,013,069	-4.89%	11.57%	11.57%
3	Maqedonia	862.860	927.978	-7.02%	10.36%	10.60%
4	Sava	848.398	886.426	-4.29%	10.19%	10.13%
5	Unika	827.544	823.176	0.53%	9.94%	9.40%
6	Halk	821.730	523.287	57.03%	9.87%	5.98%
7	Euroins	726.996	813.562	-10.64%	8.73%	9.30%
8	Viner	712.129	808.989	-11.97%	8.55%	9.24%
9	Osiguritelna polisa	602.980	710.064	-15.08%	7.24%	8.11%
10	Kroacia Jo-Jetë	460.756	459.102	0.36%	5.53%	5.25%
11	Garve Jo-Jetë	266.817	362.080	-26.31%	3.20%	4.14%
	GJITHSEJ JO-JETË	8,325,403	8,752,625	-4.88%	100.00%	100.00%

Burimi: AMS

Në pjesën e sigurimit të jetës, që përfaqëson 17.29% të PSHB-së së përgjithshme të sektorit të sigurimeve, është realizuar PSHB në një vlerë prej 1.74 miliarda denarësh (2019: 1.83 miliarda denarë), që përbën rënie prej 4.93% në raport me vitin 2019.

Individualisht në krahasim me vitin 2019, rritja e PSHB-së është vërejtur te tre shoqëri të sigurimeve të jetës (Tabela nr. 7).

Tabela nr. 7: Primi i shkruar bruto sipas shoqërive të sigurimeve të jetës (mijë denarë)

Nr.	Shoqëri sigurimesh	Primi i Shkruar Bruto (PSHB)		Dinamika	Pjesëmarrja në PSHB-në e përgjithshme	
		2020	2019		20/19	2020
1	Kroacia Jetë	654,532	805,885	-18.78%	37.61%	44.02%
2	Grave	534,483	548,376	-2.53%	30.71%	29.95%
3	Viner Jetë	305,663	291,559	4.84%	17.56%	15.93%
4	Unika Jetë	182,689	147,842	23.57%	10.50%	8.08%
5	Triglav Jetë	63,136	37,127	70.05%	3.63%	2.03%
	GJITHSEJ JETË	1,740,503	1,830,789	-4.93%	100.00%	100.00%

Burimi: AMS

Një nga treguesit më kompetentë për vëllimin e aktiviteteve të kryera të shoqërive të sigurimeve është analiza e vëllimit të aktiviteteve të kryera sipas klasave të ndryshme të sigurimit. Në këtë mënyrë, përmes të dhënave për PSHB-në sipas klasave të sigurimit, në mënyrë plotësuese është pasqyruar struktura e tregut e të gjitha shoqërive të sigurimeve në vitin 2020 (Tabela nr. 8).

Tabela 8: Primi i shkruar bruto për periudhën 01.01.2020- 31.12.2020 (mijëra denarë)

Klasa e sigurimi	Jo-jetë													Gjithsej
	Makedonija	Triglav	Sava	Evroins	Eurolink	Viner	Grawe	Unika	Osiguritelna Polisa	Halk	Kroacija			
01. Sigurimi i aksidenteve	84,864	121,866	85,721	30,226	133,116	37,523	13,325	60,224	36,611	65,946	78,973	748,395		
02. Sigurimi shëndetësor	2251	70296	10531	15883	112795	2385	0	14969	136	31489	12914	273,649		
03. Mjetet motorike kasko	66,047	147,837	143,997	55,365	83,717	49,273	8,283	67,247	90,384	58,718	52,867	823,735		
04. Mjetet hekurudhore kasko	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0		
05. Mjetet fluturuese kasko	0	0	0	0	2483	6,601	0	0	0	0	0	9,084		
06. Mjetet lundruese kasko	6	309	121	21	74	347	0	49	124	53	0	1,104		
07. Kargo	22,012	25,625	2672	8,694	4983	3,755	0	11402	693	3601	1259	84,696		
08. Prona nga zjarri dhe rrezique tjera	125,571	73,170	59,910	185,320	124,865	15,659	3638	51,929	42,052	44,462	41,631	768,207		
09. Pronat tjera	268,828	206,763	114,244	72,795	76,911	91,469	1656	51,324	12,316	183101	12,858	1,092,265		
10. AP (gjithsej)	242,389	478,534	394,166	349,762	357,363	487,092	236,642	528,436	400,386	408,606	252,921	4,136,297		
11. Përgjegësia nga mjete fluturuese	0	152	0	0	1617	4,733	0	0	285	0	0	6,787		
12. Përgjegësia nga mjete lundruese	156	477	729	90	415	106	0	189	445	99	3	2,709		
13. Përgjegësia e përgjithshme	38,155	38,953	10,651	5,574	53,025	9,849	615	27,417	13,153	12138	2,440	211,970		
14. Kredia	680	5,618	9,762	0	0	0	0	0	0	9098	0	25,158		
15. Garancia	3	196	12	62	72	0	0	0	63	128	0	536		
16. Humbjet financiare	7777	44,357	3630	328	274	0	0	7816	0	106	190	64,478		
17. Mbrojtja juridike	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3	5	8		
18. Ndhima turistike	4,121	17,461	12,252	2,876	11,869	3,337	2658	6,542	6,332	4,182	4,695	76,325		
Gjithsej	862,860	1,231,614	848,398	726,996	963,579	712,129	266,817	827,544	602,980	821,730	460,756	8,325,403		

Klasa e sigurimit	Jetë				Gjithsej
	Kroacia	Grave	Viner	Triglav	
19. Jeta	586,306	522,031	145,426	121,905	1,438,761
20. Martesa apo lindja	0	0	0	0	0
21. Sigurimi i jetës kur rreziku investues bie mbi të siguruarit	68,226	12,452	160,237	60,784	301,742
Gjithsej	654,532	534,483	305,663	182,689	1,740,503

Gjithsej:


10,065,906

Burimi:AMS

3.1.4. Struktura e pjesëmarrjes

Në PSHB-në e përgjithshme pjesëmarrje më të rëndësishme ka sigurimi i mjeteve motorike me 49.28% (viti 2019:51.17%) që përbëhet nga sigurimi obligues dominues nga auto-përgjegjësia (AO), që merr pjesë me 41.09% (2019: 43.25%), dhe nga sigurimi vullnetar i mjeteve automobilistike (kasko) që merr pjesë me 8.18% (2019: 7.92%). Një vend të rëndësishëm në strukturën e PSHB-së merr sigurimi i pronës me 18.48% (2019: 16.75%), sigurimi i jetës me pjesëmarrje prej 17.29% (2019: 6.56%) dhe sigurimi nga pasojat në rast fatkeqësie (aksidenti) merr pjesë me 7.43% (2019: 6.56%). Struktura sipas klasave më të rëndësishme të sigurimit, si dhe krahasimi me vitin 2019 është paraqitur në Grafikon nr. 4.

Grafiku nr. 4: Struktura e primit të shkruar bruto sipas klasave të sigurimit (përqindje)



Burimi: AMS

Rënie e PSHB-së prej 9.63% në raport me vitin 2019 është vërejtur në klasën e sigurimeve të auto-përgjegjësive (AP) me prim të përgjithshëm në shumë prej 4.14 miliardë denarësh (2019: 4.58 miliardë denarë) dhe ulje të numrit të marrëveshjeve të lidhura prej 12.63%, si dhe te sigurimi kasko të mjeteve motorike me prim të përgjithshëm në shumë prej 823.73 milionë denarësh (2019: 838.24 milionë denarë) dhe rritje të njëkohshme prej 0.43% në numrin e marrëveshjeve të lidhura.

Te sigurimi i pronës vërehet zmadhim prej 4.97% me PSHB 1.86 miliardë denarë (2019: 1.77 miliardë denarë), gjatë zmadhimit të njëkohshëm prej 3.75% të numrit të marrëveshjeve të lidhura. Duke analizuar sipas grupeve, te personat fizikë kemi rritje prej 1,91% të marrëveshjeve të lidhura, i ndjekur me rritje prej 4.49% të PBP-së, kurse te personat juridikë kemi rritje prej 9.81% të marrëveshjeve të lidhura dhe rritje prej 5.73% të PSHB-së.

Në suazat e sigurimit të pronës, te sigurimi bujqësor vërehet ulje prej 1.37% i numrit të marrëveshjeve të lidhura, si dhe zmadhim prej 24.81% i PSHB-së së realizuar për sigurim bujqësor i cili është 482.53 milionë denarë (2019: PSHB prej 386.63 milionë denarësh).


Në vitin 2020, vërehet rritje më e madhe në shitjen e sigurimeve shëndetësore me lidhje të 10.706 marrëveshjeve për sigurim shëndetësor me PSHB të përgjithshme prej 273.65 milionë denarësh, që në krahasim me vitin 2019 përbën rritje prej 35.60% të numrit të marrëveshjeve të lidhura, përkatësisht rritje prej 44,88% të PSHB-së të përgjithshme.

Te sigurimi i jetës është realizuar PSHB-së në shumë prej 1.74 miliardë denarësh (2019: 1.83 miliardë denarë), që përfaqëson ulje prej 4.93%, ku sigurimi i jetës merr pjesë me 17.29% nga PSHB-ja e përgjithshme e sektorit të sigurimeve.

Te sigurimi tradicional i jetës (klasa 19) është realizuar trend negativ i PSHB-së në shumë prej 1.44 miliardë denarësh (2019: 1.60) që përbën ulje prej 10.26%, me ulje të numrit të marrëveshjeve të reja të lidhura për sigurim të jetës prej 25.76%, dhe kjo kryesisht me llojin e marrëveshjeve me termin për sigurim të jetës (rriziko). Te sigurimi i jetës kur rrezikun e investimit e merr përsimër i siguruari (klasa 21), po vazhdon trendi i theksuar i rritjes prej 33.10%, me PSHB të realizuar prej 301.74 milionë denarësh (2019: 226.54) por edhe ulje të marrëveshjeve të reja lidhura prej 8.15%.

Në Grafikon nr. 5 është treguar trendi i PSHB-së sipas klasave të sigurimit.


Grafiku nr. 5: Trendi i primit të shkruar bruto sipas klasave të sigurimit (milionë denarë; boshti i djathtë – përqindjet)



Burimi: AMS

Gjatë vitit 2020 shoqëritë e sigurimeve kanë bërë 1,166,439 marrëveshje, ku është vërejtur ulje prej 27.48% në raport me vitin 2019 kur janë bërë 1,608,546 marrëveshje. Nga numri i përgjithshëm i marrëveshjeve të bëra, 1,143,766 polica janë në suazat e sigurimit jo-jetë, qëparaqet ulje prej 27.55% në krahasim me numrin e policave në vitin 2019 (2019: 1,578,629 polica), kurse 22,673 janë polica të sigurimit të jetës, përkatësisht ulje prej 24.21% në krahasim me vitin 2019. Ndryshimi i numrit të marrëveshjeve të bëra sipas klasave më të rëndësishme të sigurimit është dhënë në Grafikon nr. 6.

Grafiku nr. 6: Marrëveshje të lidhura te shoqëritë e sigurimeve (numri; boshti i djathtë - përqindja)



Burimi: AMS

3.1.1. Dëmet të paguara bruto

Shoqëritë e sigurimeve në vitin 2020 kanë paguar shuma bruto për dëme prej 4.00 miliardë denarësh (Tabela nr. 9). Në krahasim me vitin 2019, dëmet e paguara bruto shënojnë ulje prej 0.63% (2019: 4.03 miliardë denarë). Pjesëmarrja e risigurimit në dëmet e paguara bruto është 14.62%.

Tabela nr. 9: Dëme të paguara sipas klasave të sigurimit (mijë denarë)

Klasa të sigurimit	2020	%	2019	Pjesëmarrja	Dinamika 20/19
Autopërgjegjësia	1,880,406	46.95%	2,060,176	51.11%	-8.73%
Sigurimi i mjeteve motorike (kasko)	630,199	15.73%	483,427	11.99%	30.36%
Sigurimi i pronës	483,812	12.08%	542,704	13.46%	-10.85%
Sigurimi nga aksidentet	396,887	9.91%	421,000	10.44%	-5.73%
Sigurimi i jetës	436,891	10.91%	347,218	8.61%	25.83%
Sigurimi i asistencës turistike	48,110	1.20%	67,163	1.67%	-28.37%
Sigurime të tjera – jo-jetë	129,197	3.23%	109,265	2.71%	18.24%
Gjithsej	4,005,502	100.00%	4,030,953	100.00%	-0.63%


Burimi: AMS

Në strukturën e dëmeve të paguara bruto, pjesëmarrje më të madhe kanë dëmet për autopërgjegjësi me 49.95%, pastaj vijojnë dëmet për sigurime të pronës me pjesëmarrje prej 15.73%, dëmet e e paguara për sigurime kasko të mjeteve motorike me 12,08%, dëmet për për sigurime nga aksidentet me 9.91% dhe 15.33% janë paguar dëme në klasat e tjera të sigurimit.

Në pjesën e sigurimit të pronës, vend të rëndësishëm merr sigurimi bujqësor me pjesëmarrje prej 50.29% dhe me dëme të përgjithshme të paguara prej 316.85 milionë denarësh.

Në Grafikon nr. 7 është treguar pjesëmarrja individuale e shoqërive të sigurimeve në shumë të dëmeve të paguara për vitin 2020.

Grafiku nr. 7: Pjesëmarrja e shoqërive të sigurimit në dëmet e paguara bruto në vitin 2020 (milionë denarë), veçmas për jo-jetë dhe jetë



Burmi: AMS

3.1.1. Mjetet dhe burimet e mjeteve

3.1.1.1. Struktura e mjeteve

Vlera e aseteve të shoqërive të sigurimeve më 31.12.2020 është 25.97 miliardë denarë dhe është më e madhe për 7.34 % në raport me mjetet e përgjithshme të shoqëritë të sigurimeve në vitin 2019 (Tabela nr. 10).

Pjesëmarrje më të madhe prej 74.44% në strukturën e aseteve të shoqërive të sigurimit kanë investimet (2019: 76.02%) dhe ato janë rritur me 5.12% në raport me mjetet e investuara në vitin 2019. Në kuadër të investimeve, pjesëmarrje më të rëndësishme prej 92.46% zë kategoria e investimeve të tjera financiare dhe ajo ka rritje prej 6.19% në krahasim me vitin e kaluar. Në këtë kategori hyjnë: investimet financiare në dispozicion për shitje (49.30%), depozitat në banka, huatë dhe plasmanet e tjera (34.73%), investimet financiare të cilat ruhen deri në maturim (12.02%) dhe investimet financiare për tregtim (3.95%). Kategoria tjetër më e rëndësishme janë investimet në truall, objekte ndërtimi dhe mjetet e tjera materiale (6.22%) të cilat shënojnë ulje prej 7.53% në raport me vitin 2019. Gjithashtu, një pjesë e investimeve janë investime financiare në shoqëri në grup - filiale, shoqëri të bashkuara dhe entitete të përbashkëta të bashkuara, që marrin pjesë me 1.32% në investimet e përgjithshme dhe ato shënojnë ulje prej 0.96%.

Tabela nr. 10: Struktura e mjeteve të shoqërive të sigurimeve (mijëra denarë)

	31.12.2020	Pjesëmarrje	31.12.2019	Pjesëmarrje	Dinamika 20/19
Mjete jomateriale	74,013	0.29%	73,841	0.31%	0.23%
Investime	19,111,645	74.44%	18,181,249	76.02%	5.12%
Pjesë për bashkësigurime dhe risigurime në provigjonet teknike bruto	1,712,094	6.67%	1,281,907	5.36%	33.56%
Investimet financiare ku i siguruari e ndërmerr rrezikun investues (marrëveshje për sigurim)	393,704	1.53%	239,766	1.00%	64.20%
Mjete tatimore të prolonguara dhe aktuale	14,664	0.06%	19,012	0.08%	-22.87%
Të arkëtueshme	3,004,606	11.70%	2,730,388	11.42%	10.04%
Asete të tjera	563,415	2.19%	574,435	2.40%	-1.92%
Degëzime aktive të përkohshme	799,961	3.12%	817,350	3.42%	-2.13%
Mjete joaktuale të cilat ruhen për shitje dhe aktivitetet joaktuale	0	0.00%	0	0.00%	0.00%
GJITHSEJ MJETE	25,674,102	100.00%	23,917,950	100.00%	7.34%


Burimi: AMS

Në vijim sipas rëndësisë, me pjesëmarrje prej 11.70% në strukturën e mjeteve, janë të arkëtueshmet dhe ato shënojnë rritje prej 10.04% në raport me të arkëtueshmet në vitin 2019 (2019: 11.42%). Në suazat e të arkëtueshmeve futen edhe të arkëtueshmet për aktivitetet e drejtpërdrejta të sigurimeve (ku janë përfshirë të arkëtueshmet nga të siguruarit, të arkëtueshmet nga ndërmjetësuesit dhe të arkëtueshmet e tjera të aktiviteteteve të drejtpërdrejta në sigurim), të arkëtueshme të veprimtarive në bashkësigurim dhe risigurim dhe të arkëtueshme të tjera. Pjesëmarrje më të madhe prej 79.09% në të arkëtueshmet, kanë të arkëtueshmet për aktivitete të drejtpërdrejta të sigurimit në shumë prej 2,38 miliarda denarësh dhe shënojnë rritje prej 9.67% në raport me vitin 2019. Të arkëtueshmet e aktiviteteteve të bashkësigurimit dhe risigurimit kanë vlerë prej 106.19 milionësh denarë (3.53% të së arkëtueshmeve të përgjithshme) dhe shënojnë ulje prej 30.85% në krahasim me vitin 2019, si rezultat i zvogëlimit të arkëtueshmeve në bazë të pjesëmarrjes në kompensimin e dëmeve nga bashkësigurimi dhe risigurimi. Të arkëtueshmet e tjera kanë vlerë prej 522.05 milionësh denarësh (17.38% të të arkëtueshmeve të përgjithshme) dhe ato janë rritur me 8.20% në raport me vitin 2019.

Edhe pse me pjesëmarrje prej 1.53% në strukturën e mjeteve/aseteve, rritje më të madhe relative prej 64.20% vërehet te investimet financiare të cilat i siguruari e ndërmerr rrezikun investues. Shoqëritë për sigurimin e jetës të cilat punojnë në klasën 21 (Sigurim i jetës në rast kur rrezikun e investimit e merr përsipër i siguruari) kanë obligim që këto mjete, të cilat shërbejnë si mbulim i rezervës së veçantë në përputhje me nenin 94 të Ligjit për Mbikëqyrjen e Sigurimeve, t'i investojnë në pjesët e fondeve të hapura investuese që janë regjistruar në Regjistrin e Fondeve Investuese në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të cilin e udhëheq Komisioni i Letrave me Vlerë të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Struktura e pjesëmarrjes së shoqërive të sigurimeve në mjetet e përgjithshme të sektorit të sigurimeve është dhënë në Grafikon nr. 8.

Grafiku nr. 8: Struktura e pjesëmarrjes së shoqërive të sigurimeve në mjetet e përgjithshme të sektorit të sigurimeve në vitin 2020 (milione denarë), veçmas për jetë dhe jo-jetë



Burimi: AMS

Nëse analizojmë strukturën e aktiveve nga shoqëritë e sigurimeve, mund të konkludohet se kategoria kryesore e shoqërive të sigurimeve të jetës janë investimet në letrat debitore me vlerë të qeverisë dhe depozitat bankare. Nga ana tjetër, shoqëritë e sigurimeve jo të jetës kanë një strukturë tjetër të aktiveve, ku investimet në letrat debitore me vlerë të qeverisë dhe depozitat bankare përfaqësojnë gjysmën e vlerës totale të aktiveve, ndërsa gjysma tjetër përfaqësojnë të arkëtueshmet, pjesë e provigjoneve teknike bruto të transferuara në risigurime, pasuritë e paluajtshme dhe aktivet e tjera materiale dhe jomateriale, investimet në aksione në fondet e investimeve të hapura, afatet aktive, investimet në aksione, si dhe investimet në fondin e garancisë të Byrosë Nacionale të Sigurimeve.

Vlera e kategorive individuale të pasurive dhe përqindja e pjesëmarrjes në totalin e aktiveve, në ditën e fundit të vitit 2020 dhe 2019, për segmentin e sigurimeve jo të jetës dhe sigurimeve të jetës tregohen në tabelat nr. 11 dhe 12.

Tabela nr. 11: Struktura e aktiveve të shoqërive të sigurimeve jo-jetë (mijëra denarë)

Kategoria e aktiveve	31.12.2020	Pjesëmarrje	31.12.2019	Pjesëmarrje
Depozita në banka dhe në para	4,408,140	26.86%	4,460,942	28.48%
Letra me vlerë të qeverisë	4,246,559	25.88%	4,037,526	25.78%
Arkëtime	2,690,344	16.39%	2,453,434	15.67%
Provigjone teknike - pjesë e risigurimeve	1,589,433	9.69%	1,171,681	7.48%
Patundshmëri dhe aktive jopasurore	1,330,083	8.11%	1,424,330	9.09%
Pjesëmarrje në fondet investuese	792,804	4.83%	760,648	4.86%
KAK- Kufizime aktive kohore	791,571	4.82%	808,110	5.16%
Aksione	320,368	1.95%	303,719	1.94%
Pjesëmarrje në BNS	185,742	1.13%	185,147	1.18%
Tjetër	55,213	0.34%	55,448	0.35%
Gjithesj	16,410,256	100.00%	15,660,985	100.00%

Burimi: AMS

Tabela nr. 12: Struktura e aktiveve të shoqërisë të sigurimeve të jetës (mijëra denarë)

Kategoria e aktiveve	31.12.2020	Pjesëmarrje	31.12.2019	Pjesëmarrje
Depozita në banka dhe në para	6,125,446	66.12%	5,535,132	66.95%
Letra me vlerë të qeverisë	1,995,164	21.54%	1,827,502	22.11%
Investime financiare tek të cilat i siguruari e merr përsipër rrezikun e investimeve	393,704	4.25%	239,766	2.90%
Arkëtime, debi dhe avanse	386,629	4.17%	344,594	4.17%
Patundshmëri dhe aktive jopasurore	131,330	1.42%	123,977	1.50%
Provigjone teknike - pjesë e risigurimeve	122,661	1.32%	110,226	1.33%
Pjesëmarrje në fondet investuese	99,027	1.07%	75,962	0.92%
Tjetër	8,565	0.09%	9,824	0.12%
Aksione	1,320	0.01%	0	0.00%
Gjithsej	9,263,846	100.00%	8,266,984	100.00%

Burimi: AMS

3.1.1.2. Struktura e burimeve të aktiveve

Burimet e aktiveve të shoqërive të sigurimeve në vitin 2020 shënojnë rritje prej 7.34% në raport me vitin 2019 (Tabela nr. 13).

Pjesëmarrje më të madhe prej 60.39% në strukturën e burimeve të shoqërive të sigurimeve kanë provigjonet teknike bruto (2019: 59.74%) dhe ato kanë një rritje prej 8,50% në raport me vitin e kaluar.

Kategoria tjetër, me pjesëmarrje prej 29.36% në strukturën e burimeve të mjeteve, janë kapitali dhe rezervat të cilat janë rritur me 5.85%.

Obligimet e shoqërive të sigurimeve, të cilat në strukturën e burimeve marrin pjesë me 6.27% (2019: 7.30%) shënojnë ulje prej 7.75% në raport me vitin e mëparshëm. Në strukturën e obligimeve, pjesëmarrje më të madhe kanë obligimet e tjera (49.34%), obligimet nga aktivitetet me risigurimin dhe bashkësigurimin dhe obligimet e veprimtarive të drejtpërdrejta të sigurimeve (6.89%).

Tabela nr. 13: Struktura e burimeve të aktiveve të shoqërive të sigurimeve (mijëra denarë)

	31.12.2020	Pjesëmarrje	31.12.2019	Pjesëmarrje	Dinamika 20/19
Kapitali dhe rezervat	7,537,570	29.36%	7,120,892	29.77%	5.85%
Obligimet subordinare	157,269	0.61%	156,790	0.66%	0.31%
Provigjone teknike bruto	15,503,358	60.39%	14,289,238	59.74%	8.50%
Provigjone teknike bruto në raport me marrëveshjet të të cilat i siguruari e ndërmerr rrezikun investues	396,819	1.55%	239,766	1.00%	65.50%
Provigjone të tjera	71,441	0.28%	73,463	0.31%	-2.75%
Obligime tatimore të prolonguara dhe vijuese	52,131	0.20%	34,644	0.14%	50.48%
Obligime që dalin nga depoziatat e shoqërive të sigurimeve për risigurim të cedentëve, në bazë të risigurimit	86,424	0.34%	66,660	0.28%	29.65%
Obligime	1,609,890	6.27%	1,745,161	7.30%	-7.75%
Kufizime pasive të përkohshme	259,200	1.01%	191,335	0.80%	35.47%
GJITHSEJ BURIME TË MJETEVE	25,674,102	100.00%	23,917,950	100.00%	7.34%

Burimi: AMS

3.1.2. Provigjone teknike

Shuma e përgjithshme e provigjoneve teknike të shoqërive të sigurimeve që ushtrojnë aktivitetin e sigurimit jo-jetë në fund të vitit 2020 është 8.74 miliarda denarë, përkatësisht 6.03% zmadhim në krahasim me vitin e mëparshëm, kurse, përsëri, shuma e përgjithshme e provigjoneve teknike të shoqërive të sigurimit që ushtrojnë aktivitetin e sigurimit në grupin e sigurimit të jetës është 7.16 miliarda denarë, që përbën rritje prej 13.91% në raport me vitin e kaluar.

Tabela nr. 14: Struktura dhe ndryshimi i provigjoneve teknike (mijëra denarë)

Struktura e provigjoneve teknike	Jo-Jetë			Jetë			Gjithsej		
	2020	2019	20/19	2020	2019	20/19	2020	2019	20/19
Provigjone për dëmet	4,837,104	4,124,483	17.28%	92,127	92,033	0.10%	4,929,231	4,216,516	16.90%
Provigjone për primet e transferueshme	3,849,932	4,009,126	-3.97%	35,786	35,973	-0.52%	3,885,718	4,045,099	-3.94%
Provigjone matematikore	0	0	0.00%	6,909,617	6,035,373	14.49%	6,909,617	6,035,373	14.49%
Provigjone për bonuse dhe lirime	46,108	87,223	-47.14%	120,252	120,186	0.05%	166,360	207,409	-19.79%
Provigjone të tjera teknike	9,240	24,595	-62.43%	0	0	0.00%	9,240	24,595	-62.43%
Gjithsej	8,742,384	8,245,427	6.03%	7,157,782	6,283,565	13.91%	15,900,166	14,528,992	9.44%

Burimi: AMS


Në strukturën e provigjoneve teknike pjesëmarrje më të madhe kanë provigjonet për dëmet dhe provigjonet për primet e transferueshme, kurse te shoqëritë e sigurimeve që ushtrojnë aktivitete të sigurimeve në grupin e jetës, pas këtyre kategorive vendin më të rëndësishëm e zë provigjoni matematikor (Tabela nr. 14).

3.1.1. Mjetet të cilat i mbulojnë provigjonet teknike

Mjetet të cilat i mbulojnë provigjonet teknike janë ato mjete të shoqërisë së sigurimeve që shërbejnë për mbulim të obligimeve të ardhshme që dalin nga marrëveshjet e sigurimeve, si dhe për mbulimin e humbjeve të mundshme në raport me ato rreziqe që lidhen me ushtrimin e aktiviteteve të sigurimeve, për të cilat shoqëria e sigurimeve është e obliguar të veçojë mjete për mbulim të provigjoneve teknike neto. Shoqëria e sigurimeve është e obliguar të investojë mjete në vlerë, të paktën, të barabartë me vlerën e provigjoneve teknike, neto të risigurimit, në përputhje me dispozitatat e Ligjit të Mbikëqyrjes të Sigurimeve dhe në përputhje me Rregulloren e llojeve dhe karakteristikave të mjeteve të cilat i mbulojnë mjetet teknike dhe mjetet të cilat i mbulojnë provigjonet matematikore, si dhe plasimin e detajuar dhe kufizimin e atyre investimeve dhe vlerësimin e tyre ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 64/11, 127/14, 61/16 dhe 36/19).

Investimet e mjeteve që i mbulojnë provigjonet teknike te shoqëritë për sigurime jo-jetë, në fund të vitit 2020 kapin vlerë prej 8.45 miliarda denarësh dhe mbulonin 118.16% (2019: 117.29%) të provigjoneve të përgjithshme neto teknike. (Grafiku nr.9).

Grafiku nr. 9: Mbulimi i provigjoneve teknike neto te shoqëritë e sigurimit jo-jetë (miliona denarë; boshti i djathtë - përqindje)



Burimi: AMS

Mjetet të cilat i mbulojnë provigjone teknike te shoqëritë e sigurimit jo-jetë janë plasuar në letra me vlerë të lëshuara nga Republika e Maqedonisë së Veriut (48.99%), depozita në banka (37.80%), pjesëmarrje në fonde investuese (9.38%) dhe aksione (2.67%). Vlerat dhe struktura e investimeve janë dhënë në Tabelën nr. 15.


Tabela nr. 15: Mjetet që i mbulojnë provigjonet teknike te shoqëritë e sigurimit jo-jetë (mijëra denarë)

	2020	2019	2018
Llogari bankare dhe depozita në banka	3,194,914	3,345,592	3,258,311
Letra me vlerë shtetërore	4,140,434	3,977,336	3,370,466
Aksione	225,563	213,021	120,472
LV afatgjata të lëshuara nga BE-ja ose OECD-ja	0	0	36,407
Fonde investuese	792,804	760,648	474,738
Llogari bankare dhe depozita në banka	98,298	0	0
Letra me vlerë të qeverisë	8,452,012	8,296,596	7,260,394

Burimi: AMS

Në shoqëritë që operojnë sigurimin e jetës, investimet e fondeve nga provigjonet teknike dhe provigjoni matematikor arritën vlerën e 6,85 miliardë denarësh dhe kanë mbulim të provigjoneve teknike neto prej 103.28% (2019: 102.87%) (Grafiku nr. 10).

Grafiku nr. 10: Mbulimi i provigjoneve teknike neto te shoqëritë për sigurim të jetës (milione denarë; boshti djathtas - përqindje)



Burimi: AMS

Shoqëritë e sigurimeve të jetës pjesën më të madhe të mjeteve që e mbulojnë provigjionin matematikor investojnë në letra shtetërore me vlerë të nxjerra nga Republika e Maqedonisë së Veriut (74.62%), depozita në banka (24.12%) fonde investuese (0.53%) dhe në instrumente të tjera financiare (0.73%) (Tabela nr. 14).

Tabela nr. 16: Mjetet që i mbulojnë provigjionet teknike që i mbulojnë rezervat teknike dhe provigjionet matematikore te shoqëritë e sigurimeve të jetës (mijëra denarë)

	2020	2019	2018
Llogari bankare dhe depozita në banka	1,653,448	1,454,971	1,106,998
Letra me vlerë shtetërore	5,116,003	4,562,433	4,052,740
Aksione	0	0	0
LV afatgjata të lëshuara nga BE-ja ose OECD-ja	0	0	0
Fonde investuese	36,502	38,941	58,879
Tjetër	49,892	45,512	38,272
Gjithsej	6,855,846	6,101,857	5,256,889


Burimi: AMS

3.1.1. Adekuatshmëria e kapitalit të shoqërive të sigurimeve

Në përputhje me nenet 75 dhe 76 të Ligjit për Mbikëqyrje të Sigurimeve, shoqëritë e sigurimeve duhet ta ruajnë vlerën e kapitalit në madhësinë e nivel të nevojshëm të margjinës së solvencës ose aftësisë paguese. Sipas të dhënave të dorëzuara në AMS, në fund të vitit 2020, kapitali i llogaritur i përgjithshëm i shoqërive të sigurimeve⁵ kap vlerën prej 7.01 miliarda denarësh, që përbën rritje prej 5.53% në raport me vitin 2019. Duke e analizuar sipas grupeve të sigurimit, kapitali i shoqërive të sigurimit jo-jetë është 5.147 miliarda denarë, kurse e shoqërive të sigurimit të jetës 1.54 miliarda denarë. Mbi 95% e kapitalit të shoqërive të sigurimeve është kapitali bazë, respektivisht buron nga kategoritë më të larta të burimeve të fondeve, respektivisht nga kapitali aksionar i paguar nga aksionet e zakonshme të lëshuara, rezervat ligjore (statutore), si dhe fitimet e akumuluar. Pjesa e kapitalit shtesë në kapitalin e përgjithshëm të sektorit të sigurimeve është shumë e vogël. Kjo jep besim se gjendja financiare dhe aftësia paguese e sektorit të sigurimeve është e mirë

Margjina e solvencës, si indikator kryesor i vlerësimit të stabilitetit të sektorit të sigurimeve, është 1.64 miliarda denarë (te sigurimi jo-jetë 1.22 miliarda denarë, kurse te sigurimi i jetës 421 milionë denarë), kështu që kapitali i sektorit të sigurimit është 4.3 herë mbi nivelin e margjinës së solvencës apo aftësisë paguese. Lëvizja e kapitalit dhe margjina e nevojshme e solvencës te shoqëritë e sigurimeve jepet në Grafikon nr. 11

Grafiku nr. 11: Lëvizja e kapitalit dhe aftësia paguese e shoqërive të sigurimeve (milionë denarë)




Burimi: AMS

⁵Rregullorja e llojeve dhe përshkrimi të paragrafëve që do të merren parasysh gjatë llogaritjeve të kapitalit të shoqërisë së sigurimeve dhe/ose risigurimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 5/11, 64/11, 61/16 dhe 170/19")

Deri në 95.67% të kapitalit të përgjithshëm të shoqërive të sigurimeve të jo-jetës, respektivisht 98.94% të kapitalit të përgjithshëm të shoqërive të sigurimit të jetës është kapital bazë, që është një tregues i cilësisë së lartë të zërave të përfshirë në llogaritjen e kapitali total, respektivisht për gjendjen financiare të shoqërive të sigurimeve për t'iu përgjigjur rreziqeve të aftësisë paguese në rrethana të paparashikueshme të tregut.

Grafiku nr. 12: Struktura e kapitalit të shoqërive të sigurimeve (veçmas për jo-jetë), në miliona denarë dhe në përqindje të kapitalit total



Burimi: AMS

3.1.2. Rezultati financiar nga ushtrimi i aktivitetit

Gjatë vitit 2020, sektori i sigurimeve realizoi fitim në shumë prej 456.81 milionë denarësh, përkundrajt fitimit të realizuar në shumë prej 25.37 milionë denarësh në vitin 2019.

Shoqëritë e sigurimit jo-jetë realizuan fitim prej 273.81 milionë denarësh (2019: humbje prej 125.91 milionë denarësh) që del nga rezultati i dhjetë shoqërive që realizuan fitim në një shumë prej 341.83 milionë denarësh dhe katër shoqëri që realizuan humbje në shumë prej 67.72 milionë denarësh.

Shoqëritë e sigurimeve të jetës realizuan fitim prej 177.86 milionë denarësh (2019: fitim prej 100.54 milionë denarësh) që del si rezultat i katër shoqërive që realizuan fitim prej 198.64 milionë denarësh dhe një shoqëri që realizoi humbje në shumë prej 20.79 milionë denarësh.


Përmirësimi i përfitimit në segmentin e sigurimeve jo-jetë është rezultat i disa lëvizjeve. Gjegjësisht, është i dukshëm zvogëlimi i rezervave bruto për primet e transmetueshme në vitin 2020, gjë që ka një ndikim pozitiv në të ardhurat nga primi i fituar në vitin 2020, krahasuar me të njëjtin të realizuar në vitin 2019. Pastaj, ulja e dukshme e dëmeve neto në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019 (kjo rënie, kryesisht, është rezultat i aktivitetit të zvogëluar dhe rreziqeve të ndërmarrja në sigurim, në një periudhë kur në fuqi janë masat për kufizimet dhe ndalimet për udhëtime jashtë vendit, dhe rënia ekonomike për shkak të pandemisë). Një faktor shtesë për përfitimin e lartë të shoqërive të sigurimeve të jetës është kuadri rregullator i përkohshëm i krijuar nga AMS-ja gjatë pandemisë, me qëllim që të bëhen korigjime për pagesa të vonuara (të cilat janë një kosto në funksionimin e secilës shoqëri) me afate të zgjatura, të cilat padyshim përmirësuan pasqyrat financiare të shoqërive në vitin 2020 (respektivisht deri në hyrjen në fuqi të rregulloreve të përkohëshme).

Përmirësimi i përfitimit të kompanive të sigurimit të jetës është për arsye të ngjashme me kompanitë e sigurimeve jo-jetë. Rritja e provigjionit matematikor në vitin 2020 është dukshëm më i vogël krahasuar me rritjen e së njëjtit në vitin 2019. Rritja e provigjionit matematikor ndikon në rritjen e shpenzimeve totale në këtë periudhë.

Ndryshimet e mëdha në përfitimin e segmentit të sigurimeve jo-jetë (nëse analizojmë Grafikon nr.13 për vitet 2018, 2019 dhe 2020), rezultojnë nga përmirësimi i dukshëm i përfitimit në vitin 2020 i dy shoqërive të sigurimeve jo-jetë, të cilat gjatë vitit 2019 realizuan rritje të konsiderueshme në shumën e provigjioneve të dëmeve (detyrimeve), të cilat kontribuan që vitin 2019 ta përfundojnë me

humbje të mëdha. Për më tepër, gjatë vitit 2019, këto dy shoqëri të sigurimeve realizuan rakordim kontabilist të vlerës së pasurisë së paluajtshme me kërkesat e rregullores së ndryshuar, duke ulur ndjeshëm vlerën e tyre. Në të dy shoqëritë pati ndryshime të pronësisë, rikapitalizime dhe ndryshime në operacione, të cilat çuan që rezultatet financiare të arritura në vitin 2020 të ishin shumë më të mira krahasuar me vitin 2019.

Grafiku nr. 13: Rezultati financiar nga veprimtaria e shoqërive të sigurimeve në (miliona denarë)



Burimi: AMS

3.1.1. Indikatorë të sektorit të sigurimeve

Treguesit në veprimtarinë e sigurimeve përdoren për ndjekje më të mirë të aktivitetit të shoqërive të sigurimeve.

Koeficienti i dëmeve llogaritet si raport midis dëmeve të ndodhura në këtë periudhë dhe primit, kurse koeficienti i shpenzimeve përfaqëson raportin midis shpenzimeve për zbatimin e sigurimit dhe primit. Shuma e këtyre dy koeficienteve e jep koeficientin e kombinuar. Më detajisht, sipas grupeve të sigurimit në tabelën nr. 15 janë dhënë koeficientet me bazë bruto dhe bazë neto, përkatësisht pas izolimit të efektit të risigurimit.

Tabela nr. 17: Koeficiente teknike

	2020			2019		
	Koeficienti i dëmit	Koeficienti i shpenzimeve	Koeficienti i kombinuar	Koeficienti i dëmit	Koeficienti i shpenzimeve	Koeficienti i kombinuar
Neto koeficient						
Jo-jetë	47.82%	51.41%	99.23%	52.50%	51.46%	103.96%
Jetë	76.99%	28.98%	105.96%	76.66%	32.72%	109.38%
Gjithsej	53.77%	46.83%	100.60%	57.63%	47.48%	105.11%
Bruto koeficient						
Jo-jetë	50.09%	45.16%	95.25%	47.94%	45.44%	93.38%
Jetë	75.33%	28.87%	104.20%	75.60%	32.47%	108.07%
Gjithsej	54.43%	42.36%	96.79%	52.94%	43.09%	96.03%

Burimi: AMS

Norma e kthimit të investimeve (ROI) llogaritet si raport i të hyrave të zvogëluara me shpenzimet e investimeve dhe shumën e investimeve. Norma e kthimit të investimeve në nivel të industrisë për vitin 2020 është 2.96%, që shënon rritje lidhur me vitin e kaluar (2019: 2.46%). Individualisht, sipas grupeve të sigurimit, vërejmë se norma e kthimit të investimeve të sigurimi jo-jetë në vitin 2020 është 2.4%, përkundrajt 1.42% të realizuara në vitin 2020, kurse të sigurimi jetë në vitin 2020 kjo normë është 3.69% që përbën ulje në raport me vitin e mëparshëm kur ka qenë 4.00%.

Norma e kthimit nga aktivet (ROA) llogaritet si raport i fitimit neto dhe mjeteve të përgjithshme. Në nivel të industrisë ky indikator është -0.11%. Veçmas, sipas grupeve të sigurimit, norma e kthimit nga aktivet të sigurimi jo-jetë në vitin 2020 është 1.67%, përkundrajt -0.80% në vitin 2019, kurse të sigurimi jetë në vitin 2020 është 1.92% në raport me vitin e mëparshëm kur ka qenë 1.22%.

Norma e kthimit nga kapitali (ROE) llogaritet si raport i fitimit neto dhe kategorisë kapital dhe rezerva. Në nivel të industrisë ky indikator është 5.99 % përkundrajt -0.36% në vitin 2020. Veçmas, sipas grupeve të sigurimit, norma e kthimit të kapitalit të sigurimi jo-jetë në vitin 2020 është 4.74% që përfaqëson rritje në raport me vitin e kaluar kur ka qenë -2,28%, kurse të sigurimi jetë në vitin 2020 është 10,13% që flet për rritje në krahasim me vitin 2019 kur ka qenë 6.29%.

Koeficienti i borxhit llogaritet si raport i obligimeve të përgjithshme dhe mjeteve të përgjithshme. Ky koeficient dëshmon se sa prej mjeteve janë financuar nga obligimet (provigjonet teknike dhe obligimet e tjera) pa u përfshirë kapitali dhe rezervat ligjore. Në vitin 2020 ky koeficient ka qenë 70.64%, që përbën rritje në raport me vitin 2019 kur ka qenë 70.23%.

Pasqyra e të gjithë këtyre indikatorëve financiarë është dhënë në Tabelën nr. 18.

Tabela nr. 18: Indikatorët financiarë

	2020				2019			
	ROI	ROA	ROE	Borxhi	ROI	ROA	ROE	Borxhi
Jo-Jetë	2.42%	1.67%	4.74%	64.77%	1.42%	-0.80%	-2.28%	64.72%
Jetë	3.69%	1.92%	10.13%	80.66%	4.00%	1.22%	6.29%	80.66%
Gjithsej	2.96%	1.76%	5.99%	70.64%	2.46%	-0.11%	-0.36%	70.23%

Burimi: AMS

3.2. NDËRMJETËSIMI NË SIGURIME

Roli i ndërmjetësimit në shitje ka ndikim gjithnjë dhe më të madh në sektorin e sigurimeve. Gjatë vitit 2020 43.49% (2019: 46.61%) e PSHB-së së realizuar është realizuar nëpërmjet shitjes së drejtpërdrejtë nga shoqëritë e sigurimeve. kurse 56.51% (2019: 53.39%) janë realizuar nga kanalet indirekte të ndërmjetësimit (Tabela nr. 18).

Tabela nr. 18: Struktura e kanaleve të shitjes së policave sipas PSHB-së të realizuar (mijëra denarë)

	2020	%	2019	%	2018	%
Shitja e drejtpërdrejtë	4,377,661	43.49%	4,933,179	46.61%	4,838,893	48.74%
Shoqëritë e brokerimit në sigurime	3,237,761	32.17%	3,135,577	29.63%	2,745,963	27.66%
Përfaqësuesit në sigurime	1,174,967	11.67%	1,046,595	9.89%	1,053,116	10.61%
Shoqëritë për përfaqësim në sigurim	839,930	8.34%	898,496	8.49%	85,866	8.65%
Banka	393,431	3.91%	508,507	4.80%	371,757	3.74%
Agjencitë turistike	9,015	0.09%	32,593	0.31%	34,198	0.34%
Kanalet e tjera të shpërndarjes	20,700	0.21%	17,823	0.17%	15,937	0.16%
Sallon automobilash	12,425	0.12%	10,633	0.10%	9,041	0.09%
Gjithsej	10,065,890	100.00%	10,583,403	100.00%	9,927,565	100.00%

Burimi: AMS

3.2.1. Përfaqësimi në sigurime

Përfaqësimi në sigurime paraqet përgatitje dhe lidhje të marrëveshjeve për sigurim. në emër dhe për llogari të një apo më shumë shoqërive të sigurimeve. për prodhimet e sigurimit të cilat nuk janë konkurrencë midis tyre. Përfaqësimi në tregun e sigurimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut kryhet nëpërmjet përfaqësuesve në sigurime – persona fizikë. shoqëri për përfaqësim në sigurime dhe banka të cilat kanë marrë leje për ushtrimin e aktiviteteve për përfaqësim në sigurime. Nëpërmjet këtyre kanaleve në vitin 2020 janë realizuar 23.93% të PSHB-së (2019: 23.18%). përkatësisht 2.41 miliarda denarë (2019: 2.51 miliardë denarë) që përfaqëson ulje prej 1.85% në raport të vitit të kaluar.

Përfaqësimi në sigurime nëpërmjet personave fizikë. kryhet në bazë të licencës së AMS-së e cila merret pas dhënies paraprake të provimit për ushtrimin e aktivitetit për përfaqësim në sigurim. Në PSHB-në e përgjithshme përfaqësimi në sigurime nëpërmjet personave fizikë merr pjesë me 11.67%. kështu që në vitin 2020 numri i përfaqësuesve të cilët kanë pasur licencë nga AMS-ja ka qenë 1,341. Regjistri i të gjithë përfaqësuesve aktivë në sigurime gjendet në faqen e internetit të AMS-së.⁶

Numri i shoqërive për përfaqësim në sigurime në vitin 2019 mbeti i pandryshuar. respektivisht në tregun e sigurimeve operojnë gjithsej 10 shoqëri të përfaqësimit në sigurime dhe 7 banka (Tabela nr. 17). Në PSHB-në e përgjithshme shoqëritë për përfaqësim në sigurime në vitin 2020 kanë marrë pjesë me 839.93 milionë denarë ose 8.34% nga ndërmjetësimi i përgjithshëm. ndërsa në raport me vitin e kaluar është vërejtur ulje prej 6.52 % në (2019: 898.50 milionë denarë).

Gjithashtu. përfaqësimi në sigurime mund të kryejë edhe banka e cila ka marrë leje për ushtrimin e aktiviteteve të përfaqësimit në sigurime nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut. ndërsa me pëlqim paraprak nga AMS-ja. Bankat marrin pjesë me 393.43 milionë denarë ose 3.91% në PSHB-në e përgjithshme që përfaqëson ulje prej 22.63% në raport me vitin e kaluar (2019: 508.507 milionë denarë).

⁶ http://aso.mk/wp-content/uploads/2019/12/registar_licenzzirani-zastapniczi-vo-osiguruvanje-12-2019.pdf

Tabela nr. 19: Regjistri i shoqërive të përfaqësimit në sigurime dhe banka


Emërtimi i shoqërisë	
1	Shoqëri për përfaqësim në sigurime AKTIVA OSIGURUVANJE SHA Shkup
2	Shoqëri për përfaqësim në sigurime TREND-MR SHA Shkup
3	Shoqëri aksionare për përfaqësim në sigurime LAJON INS SHA Shkup
4	Shoqëri për përfaqësim në sigurime REA INSHURENS GRUP SHA Shkup
5	Shoqëri aksionare për përfaqësim në sigurime SAFE LIFE Maqedonia SHA Shkup
6	Shoqëri për përfaqësim në sigurime FORTIS SHA Shkup
7	Shoqëri për përfaqësim në sigurime LAJF VIZION SHA Shkup
8	Shoqëri për përfaqësim në sigurime MIKU JUAJ (VASH PRIJATEL) SHA Prilep
9	Shoqëri aksionare për përfaqësim në sigurime FEMILI PARTNER SHA Shkup
10	Shoqëri aksionare për përfaqësim në sigurime SIGURIMI IM (MOE OSIGURUVANJE) SHA Shkup
11	Shparkase banka SHA Shkup
12	NLB Tutunska banka SHA Shkup
13	HALK banka SHA Shkup
14	Stopanska banka SHA Shkup
15	Komercijalna banka SHA Shkup
16	UNI banka SHA Shkup
17	TTK banka SHA Shkup

Burimi: AMS

Gjatë vitit 2020 nëpërmjet shoqërive të përfaqësimit në sigurime janë bërë 71,165 marrëveshje për sigurime (polica) (2019: 84,432) që përfaqëson zvogëlim prej 15.71% në raport me vitin e mëparshëm. Nëpërmjet bankave në vitin 2020 janë bërë 145,814 marrëveshje për sigurime (2019: 144,136) që përbën rritje prej 1.16% në raport me vitin e kaluar.

Shpërndarja e PSHB-së së përgjithshme, sipas klasave të sigurimit, ndërsa e realizuar nga shoqëritë për përfaqësim dhe bankat është paraqitur në Grafikon nr. 14.

Grafiku nr. 14: Struktura e PSHB-së, sipas klasave të sigurimeve



Burimi: AMS

3.2.2. Veprimtari brokerimi në sigurime

Veprimtaritë e brokerimit në sigurime nënkuptojnë ndërmjetësim në dakordimin e mbulimit të sigurimit dhe risigurimit, si dhe gjatë realizimit të kërkesave të dëmshpërblimit pas ndodhjes së ngjarjes dëmtuese të siguruar te shoqëritë e sigurimeve dhe risigurimeve, në emër dhe në llogari të klientëve. Nëpërmjet këtij kanali të shpërndarjes, shoqëritë për veprimtari brokerimi në sigurime në vitin 2020 kanë realizuar 32.17% të PSHB-së (2019: 29.63%), përkatësisht 3.24 miliardë denarë (2019: 3.14 miliardë denarë) që përbën rritje prej 3.26% në raport me vitin e kaluar.

Në fund të vitit 2020 në tregun e sigurimeve kanë vepruar 40 shoqëri brokerimi në sigurime. (Tabela nr. 18). Gjatë vitit 2020 është dhënë leje për ushtrimin e aktivitetit të një shoqërie të re të brokerimit në sigurime (Shoqëria e brokerimit në sigurime OMADA OSIGURUVANJE SHA Shkup) dhe i është

kthyer leja për ushtrimin e aktivitetit të brokerimit në sigurime të Shoqërisë të Brokerimit në Sigurime ENSA BROKER SHA Shkup. Gjithashtu në vitin 2020 i është revokuar leja Shoqërisë të Brokerimit në Sigurime Safe Invest SHA Shkup.

Tabela nr. 20: Regjistër i shoqërive të brokerimit në sigurime


Emërtimi i shoqërisë	
1	Shoqëri aksionare e brokerimit në sigurime EUROEKSPERTS Shkup
2	Shoqëri e brokerimit në sigurime EUROMAK BROKER SHA Shkup
3	Shoqëri e brokerimit në sigurime IN BROKER SHA Shkup
4	Shoqëri aksionare e brokerimit në sigurime BFP SHA Shkup
5	Shoqëri e brokerimit në sigurime MOBILITI BROKER SHA Shkup
6	Shoqëri e brokerimit në sigurime SEDA BROKER SHA Shkup
7	Shoqëri e brokerimit në sigurime SIGURIMI YNË (NASHE OSIGURUVANJE) SHA Koçani
8	Shoqëri e brokerimit në sigurime JDB BROKER SHA Shkup
9	Shoqëri e brokerimit në sigurime DELTA INS BROKER SHA Shkup
10	Shoqëri e brokerimit në sigurime A-TIM Shkup
11	Shoqëri e brokerimit në sigurime LEGRA SHA Shkup
12	Shoqëri e brokerimit në sigurime POLISA PLUS SHA Shkup
13	Shoqëri e brokerimit në sigurime AMG PREMIUM SHA Shkup
14	Shoqëri e brokerimit në sigurime SUPER BROKER SHA Shkup
15	Shoqëri e brokerimit në sigurime KORAB INS SHA Shkup
16	Shoqëri e brokerimit në sigurime NOV OSIGURITELEN BROKER SHA Shkup
17	Shoqëri e brokerimit në sigurime CERTUS SHA Shkup
18	Shoqëri e brokerimit në sigurime STM Broker Plus SHA Shkup
19	Shoqëri e brokerimit në sigurime AM Broker SHA Shkup
20	Shoqëri e brokerimit në sigurime MEGA BROKER SHA Shkup
21	Shoqëri e brokerimit në sigurime CVO Broker SHA Shkup
22	Shoqëri e brokerimit në sigurime ASUC Broker SHA Shkup
23	Shoqëri e brokerimit në sigurime VIA BROKER SHA Gllumovë Shkup
24	Shoqëri e brokerimit në sigurime VEBER GMA SHA Manastir
25	Shoqëri e brokerimit në sigurime MAK TREND BROKER SHA Shkup
26	Shoqëri e brokerimit në sigurime SN OSIGURITELEN BROKER SHA Manastir
27	Shoqëri aksionare për kryerjen e veprimtarive të brokerimit në sigurime PORSHE BROKER Shkup
28	Shoqëri e brokerimit në sigurime XHOKER INS BROKER SHA Gjevgjeli
29	Shoqëri e brokerimit në sigurime EOS BROKER SHA Shkup
30	Shoqëri e brokerimit në sigurime PETROLL – OIL BROKER SHA Shkup
31	Shoqëri e brokerimit në sigurime AURON BROKER SHA Strugë
32	Shoqëri e brokerimit në sigurime RRIZIKO OSIGURUVANJE SHA Shkup
33	Shoqëri e brokerimit në sigurime VIN BROKER SHA Shkup
34	Shoqëri e brokerimit në sigurime BROLINS SHA Shkup
35	Shoqëri e brokerimit në sigurime MAKOAS BROKER SHA Strumicë
36	Shoqëri e brokerimit në sigurime SMART MANI SOLLUSHNS SHA Shkup
37	Shoqëri e brokerimit në sigurime IBIS OSIGURUVANJE SHA Strumicë
38	Shoqëri e brokerimit në sigurime ALFA BROKER SHA Kumanovë
39	Shoqëri e brokerimit në sigurime OMADA OSIGURUVANJE SHA Shkup
40	Shoqëri e brokerimit në sigurime ENSA SHA Shkup

Burimi: AMS

Në këtë periudhë shoqëritë e brokerimit në sigurime kanë realizuar shitje të 306,693 policave (2019: 364,925). që përbën rënie prej 15. 96% në raport me vitin e kaluar.

Shpërndarja e PSHB-së së përgjithshme. sipas klasave të sigurimit. që është realizuar nga shoqëritë e brokerimit në sigurime. është dhënë në Grafikon nr. 15

Grafiku nr. 15: Struktura e PSHB-së. sipas klasave të sigurimit



Burimi: AMS

3.3. BYROJA NACIONALE E SIGURIMEVE

Në përputhje me Ligjin për Sigurim të Detyruar në Qarkullim. Byroja Nacionale e Sigurimeve (në tekstin e mëposhtëm. "BNS") ushtron aktivitetet e parapara me marrëveshjet ndërkombëtare për sigurim të pronarëve dhe përdoruesve të mjeteve motorike. nga përgjegjësia në qarkullim (kartoni i gjelbër) dhe i përfaqëson shoqëritë e sigurimeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut në organizatat dhe institucionet ndërkombëtare të sigurimeve. BNS-ja jep dhe shtyp kartona ndërkombëtare jeshile për nevojat e anëtarëve. mban evidencën statistikore dhe kryen përpunim statistikor të të dhënave statistikore të shoqërive të sigurimeve. vendos dhe mban sistem qendror mbi evidencën e policave dhe dëmeve nga përdorimi i mjeteve motorike.

BNS-ja është anëtare e Këshilli të Byrove në Bruksel që nga viti 1994. i cili ka për qëllim të lehtësojë qarkullimin rrugor ndërkombëtar të mjeteve motorike dhe shoqëruese. nëpërmjet sigurimit nga përgjegjësia për dëme të shkaktuara nga persona të tretë. sipas kushteve të cilat janë përcaktuar në vendin e vizituar dhe garanton se personave të dëmtuar në rast të fatkeqësisë rrugore do t'u kompensohet dëmi i shaktuar me përdorim të mjetit motorik. me zbatim të legjislacionit nacional të atij vendi. Njëkohësisht. si anëtare e Këshillit. BNS-ja merr pjesë në punën e Grupit Evropian Juglindor ku marrin pjesë vendet nga rajoni.

Në BNS janë anëtare njëmbëdhjetë shoqëri sigurimesh. përkatësisht të gjitha shoqëritë për sigurim jo-jetë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në raportin për punën të cilin BNS-ja e dorëzoi në AMS. në përputhje me nenin 54 paragrafi (3) të Ligjit për Sigurim të Detyruar në Qarkullim. është pasqyruar puna financiare e BNS-së dhe puna financiare e Fondit Garantues për vitin 2020.

Me bilancin e 31.12.2020. mjetet e përgjithshme të BNS-së arrinin vlerën 318.02 milionë denarë. prej të cilave 232.51 milionë janë mjete aktuale. kurse 85.51 milionë të tjerat lidhen me mjetet joaktuale dhe në krahasim me vitin e kaluar shënojnë rritje prej 0.50%. Në mjetet e përgjithshme të BNS-së. pjesëmarrje më të madhe prej 52.20% zënë depozitat në banka. pastaj vijojnë të arkëtueshmet e shoqërive të sigurimeve me 36.40% dhe investimet në letrat me vlerë me 6.50%. Në obligimet dhe kapitalin e përgjithshëm të BNS-së në vitin 2020. kapitali ka marrë pjesë me 60.26%. kurse obligimet me 39.68%. Në vitin 2020 BNS-ja ka realizuar fitim në shumë prej 2,610 mijë denarësh (viti 2019: fitim prej 2,696 mijë denarësh).

Fondi Garantues i BNS-së

BNS-ja. në përputhje me nenin 58 të Ligjit për Sigurim të Detyruar në Qarkullim. formon Fond Garantues i cili shërben për pagim të:

1. dëmeve të shkaktuara në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut nga mjete motorike dhe shoqëruese të panjohura dhe të pasiguruara. varka dhe anije me fuqi motorike të pasiguruara. si dhe mjete të pasiguruara të aviacionit;
 2. dëmeve të shkaktuara në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut nga mjete të transportit të regjistruara për transport të udhëtarëve në qarkullimin publik. për të cilat pronarët nuk kanë bërë marrëveshje sigurimi të udhëtarëve nga pasojat e rastit aksidental - aksident;
 3. dëmeve nga sigurimet e obligueshme për të cilat personat e dëmtuar nuk mund t'i marrin pagesat për shkak të përfundimit me punë të shoqërisë së sigurimeve me të cilën është bërë marrëveshje për sigurim. ku paguhet vetëm ajo pjesë e dëmit i cili nuk është kompensuar pasuria e falimentimit të shoqërisë së sigurimeve; dhe
 4. dëmeve nga mjetet motorike të siguruara të cilat kanë prejardhje nga territori i Republikës së Maqedonisë së Veriut. për të cilat në përputhje me Marrëveshjen e Kretës dhe marrëveshjet e tjera ndërkombëtare i garanton Byroja Nacionale e Sigurimeve.
- Puna e Fondit Garantues bazohet në Ligjin për Sigurim të Detyruar në Qarkullim. si dhe Rregulloren për formim dhe përdorim të Fondit Garantues dhe Udhëzimit për mbajtjen e evidencës dhe mënyrën e pagesës së mjeteve nga Fondi Garantues. të miratuar nga BNS-ja.

Tabela nr. 21: Pjesëmarrja në Fondin Garantues sipas shoqërive të sigurimit për periudhën 01.01.2020.-31.12.2020 (mijë denarë)

Emri i shoqërisë së sigurimeve	PBP-ja e përgjithshme për të gjitha sigurimet e obligueshme	% pjesëmarrja në PBP për të gjitha sigurimet e obligueshme	Pjesëmarrje në Fondin Garantues
Maqedonia	233,392	5.70%	10,548
Trigllav	465,591	11.37%	21,042
Euroins	343,807	8.40%	15,538
Sava	383,469	9.36%	17,331
Viner	491,298	12.00%	22,204
Eurolink	354,499	8.66%	16,021
Grave Jo-Jetë	245,775	6.00%	11,108
Unika	525,037	12.82%	23,729
Osiguritelna polisa	390,471	9.54%	17,647
Halk	412,977	10.08%	18,664
Kroacia Jo-Jetë	248,961	6.08%	11,252
Gjithsej	4,095,277	100.00%	185,082

Burimi: Raporti i punës i BNS-së për vitin 2020

Shoqëritë e sigurimeve të cilat ushtrojnë aktivitete të obligueshme të sigurimeve nga autopërgjegjësia janë të detyruara të paguajnë mjete në Fondin Garantues në shumë proporcionale me primin e realizuar sipas klasave të veçanta të sigurimit të obligueshëm nga autopërgjegjësia në tremujorin paraprak. për tremujorin vijues gjatë vitit aktual.

Në përputhje me vendimin e Këshillit Drejtues të BNS-së. çdo vit kalendarik kryhet shpërndarje e re e mjeteve të Fondit Garantues në vlerë prej 3,000,000 eurosh. sipas përqindjes së pjesëmarrjes së shoqërisë së sigurimeve në primin e përgjithshëm të shkruar për të gjitha sigurimet e obligueshme. Për vitin 2020 pjesëmarrja në Fondin Garantues sipas shoqërive të sigurimeve është dhënë në Tabelën nr. 19.

Rimbursimi i dëmeve nga Fondi Garantues

Në përputhje me nenin 60 paragrafi 4 të Ligjit për Sigurime të Detyruara në Qarkullim. shoqëria e sigurimeve që ka ushtruar përpilim dhe pagesë të kërkesës për kompensim të dëmit. ka të drejtë të kthimit të mjeteve të paguara nga mjetet e Fondit Garantues.

Nga mjetet e Fondit Garantues nuk kompensohen dëmet e ndodhura nga përdorimi i mjeteve motorike të huaja të pasiguruara që qarkullojnë në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. kurse për të cilat vlejnjë marrëveshjet e veçanta ndërkombëtare në të cilat nënshkruese është Republika e Maqedonisë së Veriut.

Tabela nr. 22: Dëme të paraqitura dhe të pranuar për rimbursim të Fondit Garantues për periudhën 01.01.2020-31.12.2020

Emri i shoqërisë së sigurimeve	Numri i dëmeve të paraqitura për rimbursim	Numri i dëmeve të pranuar në Fondin Garantues	Dëme të pranuar në Fondin Garantues (dëme+gjendje) shuma në denarë
Maqedonia	79	79	13,501
Trigllav	106	105	16,860
Euroins	63	62	13,868
Sava	80	80	9,926
Viner	67	67	14,007
Eurolink	63	63	24,956
Grave Jo-Jetë	68	68	15,431
Unika	65	65	10,558
Osiguritelna polisa	70	70	8,934
Halk	50	49	7,267
Kroacia Jo-Jetë	58	58	10,291
Gjithsej	769	766	145,600

Burimi: Raporti i punës i BNS-së për vitin 2020

Në vitin 2020 në BNS nga shoqëritë e sigurimeve janë paraqitur 769 dëme për rimbursim. prej të cilave 766 dëme në shumë prej 145.60 milionë denarësh janë pranuar dhe janë rimbursuar.

Numri i dëmeve të paraqitura për rimbursim në Fondin Garantues në vitin 2020 (769) është zvogëluar me 45 dëme në krahasim me vitin 2019 (814), përkatësisht shënon ulje prej 5.53%.

Dëmi mesatar i paguar në vitin 2020 është 190,077 denarë dhe ai shënon rritje prej 46.83% në raport me dëmin mesatar të paguar në vitin 2019.

Numri i dëmeve të paraqitura dhe të pranuar për rimbursim nga Fondi Garantues gjatë vitit 2020, si dhe shuma e dëmeve të pranuar janë dhënë në Tabelën nr. 23.

Kryetari i Këshillit të Ekspertëve.
Kërste Shajnoski

Numri 02-455/3
Shkup. 16.6.2021